

THESARE

MJET FRYMËZIMI DHE UDHËRRËFYES PËR PASTORËT DHE SHËRBYESIT

numri 13 / pranverë 2018



Editorial 2

Gëzim Spahija

**Të Thyejmë Vargojtë:
Vizioni Multietnik i Perëndisë
nga Letra Drejtuar Romakëve 3**
Isaac Canales

**Kisha e Shëndetshme:
Një Përkushtim
Ndaj Marrëdhënieve të
Përzemërta dhe Dashmirëse 9**
Pablo Polischuk

**Të Ndryshëm
Por në Familjen e Tij 14**
Marcia Lednicky

**Të Përqafojmë Pasionin e
Perëndisë Për Diversitetin:
Një Teologji e Pluralizmit Racor 19**
Craig S. Keener

**Si do të Dëgjojnë?
Sfida e Mosungjillizimit 28**
Randy Hurst

**Takimi i Parë Kombëtar i Grave
të Asambleve të Perëndisë 34**
Arjana Spahija

*Tema: Përqaqimi i Diversitetit: Shërbesa e Mbretërisë
Në një Botë Multietnike*



Tema: Përqafimi i Diversitetit: Shërbesa e Mbretërisë në një Botë Multietnike

Perëndia na ka thirrur që të jetojmë e të shërbejmë në unitet, por kjo nuk do të thotë që ne nuk jemi të ndryshëm. Unitet nuk do të thotë uniformitet, por me fjalën unitet nënkuptohet edhe diversitet.

Sepse ashtu si trupi është një, por ka shumë gjymtyrë, dhe të gjitha gjymtyrët e të njëjtit trup, megjithëse janë shumë, formojnë një trup të vetëm, kështu është edhe Krishti (1 Kor. 12:12).

Në lutjen e tij të drejtuar Atit për ne, Jezusi u lut: “që të gjithë të jenë një, ashtu si ti, o Atë, je në mua dhe unë në ty” (Gjoni 17:21). Dëshira dhe vullneti i Perëndisë është që ne të jemi në dashuri dhe në unitet me Të dhe me njëri-tjetrin. Dhe kjo është një nga armët më të fuqishme që na është dhënë nga Perëndia. I ligu e di se pikërisht tek uniteti qëndron forca dhe fuqia jonë dhe për këtë arsye kërkon që me të gjitha format ta shkatërrojë atë, duke përdorur të gjithë arsenalin dhe dredhitë e tij. E vërteta është se në disa raste e arrin qëllimin, kur gjen humbje të vigjilencës nga ana e besimtarëve, si pasojë e mosnjohjes. Për këtë sot ka shumë gjëra që i ndajnë besimtarët nga njëri-tjetri, dhe në më të shumtën e rasteve këto janë gjëra jo të rëndësishme apo themelore të besimit të krishterë.

Jetojmë në një kohë të vështirë të sundimit e të dallimit të kulturave e traditave të ndryshme multi-etnike nga kombe e fise të ndryshme, ku mbajtja fort sipas traditës fetare përdoret edhe si element i

ruajtjes së identitetit kombëtar. Por Ungjilli ka qenë dhe është përmbi çdo kulturë. Na duhet që ta përqafojmë çdo ditë diversitetin tonë dhe ta ruajmë atë si një vlerë në Zotin duke besuar dhe shërbyer, të drejtuar nga e njëjta Frymë. Fjala e Perëndisë thotë:

Ka larmi dhuntish, por i njëjti Frymë. Ka edhe larmi shërbimesh, por i njëjti Zot. Dhe ka larmi veprimtarish, por është i njëjti Perëndi i cili i bën të gjitha gjërat në të gjithë (1 Kor. 12:4 - 6).

Diversitet do të thotë të respektosh të drejtën e tjetrit që të besojë dhe të shërbejë ndryshe nga ty. Dhe për këtë kërkohet maturi e krishterë, duke mos gjykuar, por duke qenë krijues për të ndërtuar sa më shumë ura bekimi, bashkimi e shërbimi. I jemi mirënjohës Perëndisë për mënyrën se si ka vepruar në Shqipëri, përmes organizimeve të ndryshme, si AEP apo VUSH. Janë të ndryshëm, por nën të njëjtën çadër, duke lëvizur dhe motivuar njëri-tjetrin për ta shtrirë mbretërinë e Perëndisë në një zonë multi-etnike, siç është edhe zona e Ballkanit.



GËZIM SPAHIJA, Drejtor Ekzekutiv, Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë të Shqipërisë.

THESARE

Numri 13
Pranverë 2018

Koordinator e projektit: Stephanie Plagenhoef
Përkthyes: Fabian Tozharaku
Redaktues: Skënder Hoxha
Grafika kompjuterike: Lindita Sqapi

Botuar nga:

Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë të Shqipërisë

Në bashkëpunim me:

Life Publishers International

Adresa: K.P. 119 / Kutia 2 / Tirana, Albania

Cel: (+355) 69-406-8956

Email: KTU@icc-al.org



Artikujt e zgjedhur dhe grafika përshtatur nga revista Enrichment - ©Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë, ShBA. Përdorur me leje.

©Life Publishers International. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

TË THYEJMË VARGOJTË:


Vizioni multi-etnik i Perëndisë nga Letra Drejtuar Romakëve

Është e nevojshme që të krishterët ta përqafojnë qëllimin që Perëndia ka për qytetërimin dhe historinë. Qëllimi i Tij është i shprehur me një madhësi të mprehtë në Letrën e Palit Drejtuar Romakëve, pra, që Ai të thërrasë një popull për emrin e Tij dhe që të gjitha kombet të mblidhen për të adhuruar në shtëpinë e Tij. Vizioni multi-racor i Perëndisë është, në mënyrë reciproke, gjithëpërfshirës për Izraelin e Ri. Duke qenë se vizioni i Perëndisë për kombet ka qenë adhurimi shumëkulturore, urdhri për Izraelin në Dhjatën e Vjetër ka qenë qartësisht një mandat *missionar* dhe *global*.



Nga: ISAAC CANALES





Hebrenjtë e refuzuan thirrjen e Perëndisë për të ungjillëzuar, por profetët e korrighuan refuzimin që hebrenjtë i bënë kombeve. Jezusi e bëri të qartë se Mbretëria ishte globale, dhe jo thjesht vendore. Te Letra Drejtuar Romakëve, Pali e bën sërish të qartë: “Por atij që mund t’ju fuqizojë juve sipas ungjillit tim dhe predikimit të Jezu Krishtit . . . tani u shfaq me anë të Shkrimeve të profetëve, sipas urdhërimit të Perëndisë të përfetshëm dhe u njoh ndër të gjitha kombet, për t’i sjellë në bindjen e besimit” (Rom. 16:25, 26).

Ungjilli ka për qëllim që, nga e gjithë bota, të grumbullohet një popull për Perëndinë i cili i ngjan një buqete të përzier dhe ekzotike. E ardhmja e kishës, pra, e organizmit më të madh në botë, është heterogjene me anë të vullnetit kozmik, vizionit profetik dhe synimit të mbinatyrshëm. Ne kemi një mandat biblik dhe pastoral që, gjatë epokës sonë, të lëvizim bashkë me Perëndinë drejt një vizioni më heterogjen të kishës, duke përdorur Letrën Drejtuar Romakëve si udhërrëfyesin tonë.

Teologjia shumëkulturore e gjendur tek Letra Drejtuar Romakëve shpaloset si rrjedhojë e kuptimit të thellë që Pali ka rreth qëllimit të Perëndisë për kombet në Dhjatën e Vjetër. Pali e pa planin që Perëndia kishte për kombet si lajmin e mirë që ishte premtuar tek librat e profetëve (Romakëve 1:2). Dhuntia e tij si apostull për kombet është e rrënjësuar në mandatin biblik që Perëndia kishte për Izraelin: se shpëtimi ishte për cilindo “që beson, më parë judeun e pastaj grekun” (Romakëve 1:16).

SYNIMI I PERËNDISË

Që prej fillimit të Shkrimit, synimi i Perëndisë ishte që të zbulonte qëllimet e Tij për botën nëpërmjet Izraelit, popullit të Tij të zgjedhur (Romakëve 1:20; 3:2). Fillimisht, ai zgjodhi Abrahamin si atin e judenjve. Perëndia e thirri Abrahamin që të dilte nga Babilonia e lashtë. Abrahami iu bind Perëndisë me besim dhe mori shenjen e rrethprerjes (Romakëve 4:11).

Perëndia premtoi se do ta bënte Abrahamin jo vetëm atin e judenjve, por edhe atin e shumë kombeve (Zanafilla 12:3; 17:5; Romakëve 4:18). Marrëdhënia e Perëndisë me Abrahamin dhe me Izraelin, shpalosi qëllimet e Tij dhe gjithashtu zbuloi refuzimin plot krenari që Izraeli iu bëri qëllimeve të Tij (Rom 10:3).

Perëndia zgjodhi Abrahamin dhe e nxori atë nga mesi i grupeve të tjera të njerëzve, që ishin

shumëkulturore, të cilët adhuronin perëndi pagane. Ai e thirri Izraelin që të adhuronte vetëm Atë dhe i mësoi Izraelit t’u mësonte të tjerëve që të bënin të njëjtën gjë (Romakëve 2:17-21). Përmes besëlidhjes së Tij, synimi origjinal i Perëndisë ishte që të zbulonte natyrën e Tij përpara të gjithë kombeve. Përmes popullit të Perëndisë, i Plotfuqishmi dëshironte t’u shfaqte të gjitha kombeve karakterin e Tij. Ai dëshironte ta përdorte Izraelin si shembullin për të gjitha kombet, pra, fqinjët duhet ta duan njëri-tjetrin dhe të kujdesen për njëri-tjetrin. Kjo tregoi se që prej krijimit Perëndia është një Perëndi shumëkulturore. Ai i dha popullit të tij një mision shumëkulturore: t’i sjellim të tjerët në besëlidhjen tonë.

VIZIONI I PROFETIT ËSHTË I PËRZIER

Tek Letra Drejtuar Romakëve, Pali iu referohet vazhdimisht profetëve, veçanërisht profetit Isaia. Isaia e kuptonte zemrën e Perëndisë për të pasur larmi kombesh.

Pali, duke trajtuar konfliktet kulturore midis hebrenjve dhe johebrenjve në kishën e Romës, vendosi disa direktiva shumë-kulturore për kishën përgjatë shekujve.

Tek profetët, Zoti foli një fjalë shumëkulturore: “Unë, Zoti, të kam thirrur sipas drejtësisë dhe do të të zë për dore, do të të ruaj dhe do të të bëj aleancën e popullit dhe dritën e kombeve” (Isaia 42:6). “Bijtë e të huajve që janë bashkuar me Zotin për t’i shërbyer, për të dashur emrin e Zotit . . . do t’i çoj në malin tim të shenjtë dhe do t’i mbush me gëzim në shtëpinë time të lutjes; holokaustet e tyre dhe flijimet e tyre do të pëlqehen mbi altarin tim, sepse shtëpia ime do të quhet shtëpi lutjeje për të gjithë popujt” (Isa 56:6, 7).

Pali e kishte kuptuar se vizioni për të arritur kombet, i shprehur nga Isaia dhe nga profetët e tjerë, kishte ardhur nga zemra e Perëndisë. Ky ka qenë misioni i Izraelit dhe tani është misioni i kishës. Është një mision profetik. Është një mision biblik. Është një mision thelbësor. Perëndia nuk ishte thjesht duke ia sugjeruar Izraelit këtë vizion shumëkombësh. Ata *duhej* të ishin drita e botës. Izraelit iu dha një detyrë misionare.

Pali na kujton për detyrën e Izraelit tek Romakëve 9-11. Ky vizion gjithashtu shfaqet qartësisht edhe tek Romakëve 15:7. Ai fillon me një teologji mikpritjeje, e cila është në vazhdimësi të asaj që gjejmë në

Dhjatën e Vjetër dhe është baza për adhurimin dhe bashkësinë shumëraciale. Ajo që është zbuluar në qëllimet e Perëndisë për Izraelin e Dhjatës së Vjetër vazhdohet edhe në Dhjatën e Re. Për shembull, Perëndia nguli këmbë që izraelitët të pranonin të huajt: “Sepse Zoti, Perëndia juaj, është Perëndi i perëndive . . . që nuk është fare i anshëm dhe nuk pranon dhurata, që u siguron drejtësi jetimëve dhe të vejave, që e do të huajin dhe i jep bukë dhe veshje. Duajeni, pra, të huajin, sepse edhe ju ishit të huaj në vendin e Egjiptit” (Ligji i Përtërirë 10:17-19). Jezusi i konsideroi kombet si delet e Tij të tjera (Gjoni 10:16); gjithashtu edhe Pali e kuptoi këtë parim të larmisë kulturore (Romakëve 15), siç e kuptoi edhe Gjoni (Zbulesa 7:9, 10).

TË HUAJT JANË PJESË E BESËLIDHJES

Izraelitët duhet t’i sillnin këta të huaj në besëlidhjen e tyre dhe duhet t’i fitonin ata për dashurinë e Perëndisë përmes mikpritjes dhe përmes zbulesës së Perëndisë për mirësinë dhe për besnikërinë e Tij. Në rast se ata do të pendoheshin e do të largoheshin nga rrugët e tyre pagane si dhe do të përqafonin kulturën dhe besimin hebraik, të konvertuarit mirëpriteshin dhe pranoheshin si pjesë e popullit të Perëndisë. Jezusi dhe Pali iu kujtuan judenjve neglizhimin dhe refuzimin që ata i kishin bërë misionit të tyre. Çdo profet që ishte para Jezusit dhe Palit iu kujtoi izraelitëve refuzimin e tyre plot krenari të këtij mandati shumëkulturore dhënë nga Perëndia.

VIZIONI SHUMËRACOR I PERËNDISË

Megjithëse Perëndia ua bëri të qartë judenjve se pozicioni i tyre i privilegjuar ishte i dhënë dhe jo i fituar, ata ndiheshin rehat dhe të vetëkënaqur që ishin zgjedhur. Ata harruan se nuk ishin zgjedhur për shkak se ishin të veçantë; por ishin të veçantë për shkak se ishin zgjedhur. Ata nuk ua vunë veshin urdhërimeve gjithëpërfshirëse për dashuri dhe drejtësi, dhe ata banuan të sigurt dhe të pacenuar në zonën e tyre të rehatisë (Mikea 6:8; Levitiku 19:18). Ata harruan se Moisiu ishte martuar me një grua afrikane, Abrahami ishte nga vendi ku ndodhet Iraku i

sotëm dhe Ruthi ishte një moabite pagane. Gjenealogjia e Mesias ishte shumëracore. Në histori nuk ka pasur asnjë linjë pasardhësisht me gjak të pastër hebraik. Ata harruan se vetë trashëgimia e tyre ishte e larmishme, dhe si për ironi, i lanë jashtë të tjerët nga bekimet e Perëndisë së Izraelit. Ata u bënë arrogantë në aftësitë e tyre për të respektuar ligjin e Perëndisë. Ata e harruan plotësisht arsyen se përse Perëndia i kishte hequr mënjanë; dhe humbën mandatin e tyre shumëkulturore për të qenë një dritë për kombet. Si rrjedhojë, misioni i tyre u vetë-shkatërrua, duke përfunduar në një situatë të përqendruar tek krenaria etnocentrike. Izraelitët e zëvendësuan vizionin shumëkulturore të Perëndisë duke justifikuar ngritjen që ata vetë i bënë historisë së tyre, traditave dhe praktikave të rrepta fetare. Ata kishin fituar unitetin, por nuk kishin asnjë mision. Aty ku ujërat e misionit nuk po rridhnin më, i gjithë uji u bë i ndenjur.

IDEJA E TË QENIT SHUMËRACOR ËSHTË VIZION PROFETIK

Jezusi, nga ana tjetër, pra, Perëndia i shfaqur plotësisht si njeri, në kontrast të madh me bashkëkombësit e tij izraelitë, e jetoi në mënyrë të fuqishme dhe radikale teologjinë e mikpritjes nga Dhjata e Vjetër. Ai shkaktoi diskutime të zjarrta. Ai e tronditi institucionin qeverisës, por ishte jashtë-zakonisht i singertë ndaj tij. Jezusi përqafoi lebrsët, grekët dhe qentë (një term jude për johebrejtë). Ai mirëpriti çdo mëkatar të penduar në mbretërinë e Tij të shërimit dhe të intimitetit me Perëndinë, përmes përqafimit që Ai i bëri botës shumëracore dhe mëkatore. Ai pohoi se bënte vetëm atë që Ai shihte se po e bënte Ati i Tij (Gjoni 8:28). Mirëprerja që Ai iu bënte johebrejve dhe mëkatarëve e përmbushi ligjin dhe profetët (Mateu 5:17-20), si dhe i sfidoi farisenjtë që të fokusoheshin tek temat shumë të larta të Shkrimit dhe jo të përqendroheshin tek ato më të parëndësishmet. Tek Letra Drejtuar Romakëve, Pali na kujton për qëndrimin shumë-kulturore të Jezusit: “të jeni të së njëjtës mendjeje midis njëri-tjetrit, sipas Jezu Krishtit” (Romakëve 15:5).

**Nga vetë natyra e saj,
mbretëria e Perëndisë konfirmon,
përfshin dhe transformon çdo
kulturë që e përqafon.**



Jezusi ia shfaqti në mënyrë të plotë Palit këtë kulturë të mbretërisë së Perëndisë. Pali e pa Jezusin si masën e asaj që është e vërtetë dhe e mirë, pra, ato gjëra që janë të panegociueshme në besimin e krishterë. Mbretëria e Tij është standardi i të gjitha vlerave, doktrinave dhe karakteristikave kulturore. Pali tha: “Sepse mbretëria e Perëndisë ... është ... drejtësi dhe Ohirin e Perëndisë për të sjellë në jetë “bindje në besim midis të gjithë kombeve për emrin e tij”. Ai e mbyll letrën me të njëjtin mandat (Romakëve 16:26).

Fjala këtu për kombet është “ethneis”, prej nga marrim fjalën “etnik” (jo jude). Romakëve 1:16 na kujton se lajmi i mirë i dashurisë besëlidhëse të Perëndisë është “më parë judeun e pastaj grekun”. Para kësaj, si një i krishterë jude, Pali e përkufizoi veten e tij me përlësi dhe me ndërgjegje si një misionar për barbarët dhe grekët (Romakëve 1:14). Është e qartë se ai ishte apostulli shumëkulturore. Nëse sot kemi shqetësime shumëkulturore, atëherë mund t’i drejtohem Librit të Romakëve për përgjigje.

ZBULESA SHUMËRACORE E PERËNDISË NË KISHË

Ndërkohë që Pali ngulte këmbë në interesimin e tij misionar për tek kombet e botës, ai zbuloi të vërtetën e madhe profetike që të gjithë, si judenjtë edhe grekët, nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë dhe po ashtu të gjithë janë drejtësuar falas nëpërmjet besimit tek Krishti (Romakëve 3:22, 23, 24). Ai e paraqet publikisht Abrahamin, si atin e kombeve, si një shembull të besimit me bindje. Ai i bën thirrje Izraelit që të kujtojë misionin e tij të harrur për tek

kombet: “Sa të bukura janë këmbët e atyre që shpallin ungjillin e paqes, që shpallin ungjillin e së mirës!” (Romakëve 10:15).

Në një mesazh profetik edhe më provokues, Pali i kujton Izraelit të pabindur qëllimin shumëfaktor të Perëndisë pavarësisht kundërshtimit të tij mendjengushtë: “Unë u gjeta nga ata që nuk më kërkonin, unë iu shfaqja atyre që nuk pyesnin për mua”. Por lidhur me Izraelin thotë: “Gjithë ditën i shtriva duart e mia drejt një populli të pabindur dhe kundër-thënës”. (Romakëve 10:20, 21).

Perëndia i kujtoi Izraelit (ashtu siç bën me çdo pastor) se populli e kishte humbur ndjenjën e tij të misionit në botë për shkak të dëshirës së tyre për të qëndruar në zonën e tyre kulturore të rehatisë. Ky duhet të jetë një mësim për ne sot. Mandati ynë është që t’i përziejmë ngjyrat, që nga rreshtat e kishës, tek skena e deri tek bordi, sa më shumë të jetë e mundur nga ana demografike aq më mirë, dhe ta lejojmë Frymën e Shenjtë që të vendosë penelin mbi kanavacë.

FOKUSI PËR TË QENË BIBLIK

Ndërsa i hedhim sytë rreth e rrotull vendit tonë, na kujtohet se qëllimi i Perëndisë është që të gjitha kulturat, gjuhët dhe të gjithë llojet e njerëzve të adhurojnë në shtëpinë e Tij si pjesëtarë të familjes së Tij. Ne iu themi miqve tanë se në mbretërinë e Perëndisë të gjithë janë të mirëpritur. Por ç’lloj mikpritje është ajo?

Trënjja e hipokrizisë ungjillore është një vetë-kënaqësi e vazhdueshme, një paaftësi historike për të kuptuar mëshirat e Perëndisë që nuk dështojnë për askënd, si dhe dashurinë e Tij të pandryshuar



Prandaj, një pyetje mund të

shtrohet për çdo pastor:

A duhet të ndërtoj një

kishë që na izolon nga të

tjerët, apo duhet të përqafoj

teologjinë e Palit për mikpritjen?

për ata persona në mesin tonë të cilët janë të padëshiruar. Në atë masë që ndjenja që kemi për vlerën tonë mirëmbahet përmes fesë dhe kulturës, që nga ngjyra jonë tek etika e punës sonë, e deri tek lagjja ku jetojmë, ajo është masa me të cilën qëndrojmë të pavarur nga Perëndia dhe të vetëkënaqur në vetëmjaftueshmërinë tonë. Krishti nuk mund të na ndihmojë. Në atë masë që të fortët tek Romakëve 15:1, të cilët janë në kishat tona, refuzojnë të mbartin barrën e të dobëtëve nga kulturat e tjera, ajo është masa në kishat tona që ne i pëlqejmë vetvetes dhe jo Krishtit. “Sepse edhe Krishti nuk i pëlqeu vetes së tij”, na thotë Pali (Romakëve 15:3).

Prandaj, një pyetje mund të shtrohet për çdo pastor: *A duhet të ndërtoj një kishë që na izolon nga të tjerët, apo duhet të përqafoj teologjinë e Palit për mikpritjen?* (Romakëve 15:7). Është e lehtë të ngremë një kishë me një ngjyrë dhe me një gjuhë. Kushdo mund të ngrejë një kishë me një ngjyrë dhe me një kulturë. Megjithatë, përpikuni të përziheni me qëllim. Përpikuni të ndërtoni një kishë shumë-racore nëse jua lejon vendi, koha dhe kushtet demografike. Kjo është një sfidë. Por kjo është ajo për të cilën Krishti vdiq dhe u ringjall. Ia vlen ta sakrifikojmë rehatinë për përzierjen e lavdishme të një mijë gjuhëve.

RRUGA E PERËNDISË MUND TË MOS JETË RRUGA E LEHTË

Pali tek Romakëve 15:7, duke pasur ndër mend konfliktin midis hebrenjve dhe johebrejve në Romë dhe në shumë prej kishave të tij, thotë: “Prandaj pranoni njëri-tjetrin, sikurse edhe Krishti na pranoi për lavdinë e Perëndisë”. Këto fjalë shprese dhe lavdie u dhanë duke pasur parasysh konfliktin kulturor në kishë. Rruga më e lehtë do të kishte qenë të formohej një kishë për hebrenjtë dhe një kishë për johebrejntë. Por rruga e Perëndisë mund të mos jetë rruga më e lehtë. Rruga më e vështirë i sjell Perëndisë më shumë lavdi.

Të dobëtët tek Romakëve 14:1 ishin të krishterët hebrenj. Të fortët tek Romakëve 15:1 ishin johebrejntë krenarë të cilët i përçmonin rregullat e hebrenjve rreth dietës. Lavdia e Perëndisë është që këta ishin në të njëjtën kishë duke u përpjekur të merreshin vesh. Vëllezërit hebrenj nuk hanin as proshutë as bërçolla gici. Të krishterët johebrej, të cilët supozohej se po jetonin me anë të besimit, mund t’i shijonin këto ushqime me një ndërgjegje të pastër. Pali u kujtoi të dyja kulturave se Krishti vdiq për ndryshimet që ne kemi me njëri-tjetrin. Vepra e

Tij ishte për të bashkuar dhe jo për të përçarë (Romakëve 14:19). A ka ushqimi në të vërtetë më shumë vlerë?

Gjëja më e rëndësishme sot është që të heqim dorë nga frika e atyre gjërave që nuk janë si ne, dhe të adoptojmë qëndrimin e Krishtit, i cili ishte një shërbëtor (Romakëve 15:8) që mbahej nga dashuria për të dobëtët.

PRANIM NUK DO TË THOTË TOLERIM

Pali na mëson tek Romakëve që t’i luftojmë me sukses çështjet e shumëkulturalizmit dhe të mos dorëzohemi para zgjidhjeve të botës sonë. Kur ne përballemi me problemet e kulturave të larmishme në bashkësi duke e përqaftuar dhe duke e pranuar njëri-tjetrin në Krishtin është njësoj si t’i themi jo përgjigjeve të botës. Përgjigjet e botës janë: paragjykimi, racizmi, ndasia, dhuna, toleranca dhe miqësia në zonën e rehatisë. Pali nuk tha ta toleroni njëri-tjetrin. Toleranca është një racizëm i sjellshëm, një mëkat i heshtur. Pali thotë “pranoni” njëri-tjetrin, dhe jo toleroni njëri-tjetrin (Romakëve 15:7). Fjala *proslambano* do të thotë të pranosh dhe mirëpresësh, dhe jo të tolerosh apo të durosh.

Fjala “pranoni” (Romakëve 15:7) ka kuptimin e një përqaftimi të madh. *Proslambano* do të thotë përqafoj. Tek Libri i Romakëve, përgjigja e Palit ndaj ndasisë është përqaftimi shumëracor. Perëndia nuk preferon një ngjyrë në një kohë kur të gjitha ngjyrat mund të jenë në bordin, stafin, familjen apo skuadrën tuaj. Kostot e mbretërisë kur shpërfillim mandatin biblik për një adhurim shumëracor janë tepër të larta. Siç na e kujton edhe Pali, kisha duhet t’i mbajë sytë tek Shkrimi për të parë të ardhmen sipas vullnetit të Perëndisë, duke shkëputur vargonjtë tanë të zonave raciale të rehatisë, të individualizmit dhe të tolerancës së sjellshme. Neve na është caktuar rruga tek Romakëve 14:1 deri tek 15:1-13. Prandaj, “pranoni njëri-tjetrin, sikurse edhe Krishti na pranoi për lavdinë e Perëndisë” (Romakëve 15:7).



ISAAC CANALES, është pastori kryesor në kishën e familjes Misioni Ebenezer, Karson, Kaliforni.





Kisha e

Shëndetshme:

Një përkushtim ndaj

marrëdhënieve të

përzemërta

dhe dashamirëse

Nga: PABLO POLISCHUK

Marrëdhëniet e shëndetshme në trupin e Krishtit

mund të përkufizohen si miqësi të cilat përjetojnë mirësi nga njëra anë dhe mungesën e së keqes nga ana tjetër. Barrierat e natyrshme të miqësisë së vërtetë ushqehen nga ndryshoret demografike gjithnjë të pranishme siç janë, racizmi, etnocentrizmi, shtresa sociale, niveli i arsimit, fuqia ekonomike dhe arritjet personale. Orvatjet mëkatore të cilat përmenden tërthorazi tek libri i Predikuesit, pra, pasuria, puna, urtësia dhe jetesa e shfrenuar, na katandisin në një gjendje të robëruar pas përpjekjeve tokësore. Përpjekjet e tilla konkurruese na izolojnë dhe na veçojnë nga njëri-tjetri, si dhe na pengojnë që të fokusohemi tek njëri-tjetri me dashuri dhe përkujdesje.

SFIDA E DIVERSITETIT

Përgjithësisht, kishat karakterizohen nga grupe njerëzish, grupe të cilat janë të përcaktuara në mënyrë të natyrshme dhe demografike. E megjithatë, konteksti në të cilin jetojmë është i mbushur me larmi apo shumëllojshmëri kulturore dhe etnike, si dhe ka dalë më në pah një realitet etnish të ndryshme dhe kulturash të larmishme.

Por sfida për t'u angazhuar në marrëdhënie të përzemërta dhe dashamirëse në një kontekst etnish të ndryshme dhe kulturash të shumëllojshme nuk është diçka e re. Që prej kohës së Kishës së Hershme në librin e Veprave të Apostujve, kisha është përballur me dilema të tilla. Përzgjedhja e dhjakëve erdhi si përgjigje ndaj kërkesave të parashtruara nga dallimet ndërkulturore në shpërndarjen e ushqimit ndër të vejat me prejardhje hebraike dhe heleniste (Veprave 6:1-6). Parehatia ngurruese e Pjetrit për të pranuar sfidën që të ungjillëzonte një kryeqindës romak është treguar me tone të buta, por të fuqishme, të cilat adresojnë etnocentrizmin e Pjetrit (Veprat 10:28, 29, 34, 35). Këshilli i parë që u mbajt në Jerusalem adresoi dilemën që lidhej me praktikën dhe zakonet që parashtronte shkrirja e hebrenjve dhe johebrenjve në të njëjtin trup (Veprat 15). Njëzet e një shekuj më vonë, në gjendjen ekzistuese ndërkulturore të ditëve tona, ne kemi sfidat tona me të cilat përballemi.

DUKE KREMTUAR UNITETIN E PËRZEMËRT DHE DASHAMIRËS NË MES TË LARMISË

Çfarë mund të bëjmë për ta kremtuar sinqerisht unitetin në mes të larmisë? Çfarë mund të bëjmë për ta ushqyer atë unitet që përshkruhet në lutjen e Jezusit tek Gjoni 17? Përveç ndjenjave që kemi për këtë çështje, apo tendencave aktuale në shoqëri, qëndrimet, vlerat dhe praktikën tona shpesh largohen nga ajo që Perëndia ka përkufizuar si realitet. Kjo përfshin mënyrat përmes të cilave duhet të lidhemi dhe të ndërveprojmë, si edhe të përkujdesemi për njëri-tjetrin. Tek Dhjata e Re, termin “njëri-tjetri” e hasim 52 herë. Urdhërimet e Shkrimit na çojnë drejt faktit që ne i përkasim familjes së Perëndisë, nga e cila ne përftojmë emrin tonë (Efesianëve 3:14, 15).

Të përftojme emrin nga Perëndia do të thotë që të jemi të përcaktuar nga krijuesi, autori dhe planifikuesi i ekzistencës njerëzore. Të jemi të quajtur sipas Perëndisë do të thotë që të jemi të përfshirë në parametrat e vullnetit dhe qëllimit të Tij, pra, që të jemi dhe të bëjmë atë që Perëndia ka përfytyruar që përpara themelimit të botës. Bazat e identitetit tonë, se kush jemi dhe se çfarë duhet të bëjmë, na janë dhënë te Shkrimi dhe për to është dëshmuar nga Fryma e Shenjtë që prej ditës së Rrëshajave e në vazhdim.

Ne të gjithë rrjedhim nga Adami, njeriu i parë. Por nga Jezu Krishti, Njeriu i dytë, ne përftojme një njerëzim të ri. Megjithëse Perëndia zgjodhi Abrahamin për të qenë themeluesi i një kombi të veçantë, së bashku me një sërë mandatesh të qarta që u dhanë tek Ligji (Besëlidhja e Vjetër), Perëndia i marrëdhënieve tani ka nisur një Besëlidhje të Re me ata të cilët i besojnë ungjillit. Në vend të një liste të re mandatesh, apeli është që të pranojmë sfidën për të qenë imitues të Perëndisë, si dhe të pajisemi me fuqinë për të ecur në dashuri ashtu siç bëri Krishti, dhe të shfaqim sjellje të përzemërta me dashuri që janë karakteristikë e fëmijëve të dashur (Efesianëve 5:1, 2). Terma të tilla janë të ngulitura në zemrat dhe në mendjet tona (Jeremia 31:33; Hebrejve 8:10; 10:16) dhe janë të njëanshme, proaktive në mënyrë të pakushtëzuar, plot hir, plot mëshirë, plot falje, harrojnë keqbërjet, janë fuqizuese, duke na drejtuar në intimitet dhe duke sjellë një ripërtëritje të vazhdueshme dhe transformim të qenies sonë.

Janë të dukshme efektet e të qenit të thirrur (të ftuar) nga Perëndia dhe efektet e pranimit të pohimeve të Tij: Tani e tutje ne nuk vështrojmë askënd sipas pikëpamjes njerëzore. Që do të thotë, se ne nuk e themelojmë komunitetin apo bashkësinë mbi bazat e premisave kulturore apo etnocentrike, por mbi ripërkufizimin e qenies sonë në Krishtin. Pali shton se edhe nëse do ta vështronim Krishtin nga një perspektivë e tillë (sipas mishit), prapëseprapë nuk e konsiderojmë më ashtu (2 Korintasve 5:16). Dhe kështu, bashkësia ose miqësia jonë nuk varet nga ngjashmëria kulturore apo etnike, dhe as nga dallueshmëria kulturore. Por varet tek të qenit të rrënjësuar në një Perëndi përcaktues nga i cili ne përftojme emrat tanë, dhe nga të qenit të varur ndaj një mandati që është mbi kulturën për të pranuar njëri-tjetrin në Krishtin.

Sfida për t'u
angazhuar në
marrëdhënie të
përzemërta dhe
dashamirëse në një
kontekst etnish të
ndryshme dhe
kulturash të
shumëllojshme nuk
është diçka e re. Që
prej kohës së Kishës
së Hershme në librin
e Veprave të
Apostujve, kisha
është përballur me
dilema të tilla.

Perëndia e shpëtoi këtë shërbesë

Pastor Rasëll Hoxhins (Russell Hodgins) erdhi në Qendrën e Krishterë Ndërkombëtare në Ishullin Staten të Nju Jorkut rreth 19 vite më parë. Ai pranoi drejtimin pastoral të një bashkësie me rreth 100 vetë. Ai gjithashtu pranoi barrën e një kishë që po përballej me dëbim nga prona dhe me rrënim financiar.

QKN-ja pati një histori të gjatë e të frytshme në Bruklin përpara se të zhvendosej në Ishullin Staten në vitin 1980. Por kur pastori themelues i kishës pranoi një shërbesë të re pak pas zhvendosjes, bashkësia u tkurr dhe borxhi i akumuluar doli jashtë kontrollit.

“Në kohën kur unë erdha, në tetor 1998, interesi kishte shkuar në 1000 dollarë në ditë”, tha Hoxhins. “Sfidat ishin kaq shumë përtej aftësive të çdo njeriu, sa që do të duhej ndërhyrja e Perëndisë, pra, pak a shumë, një hapje e defit të Kuq. Perëndia e shpëtoi këtë shërbesë”.

Kur njerëzit e pyesin Hoxhins se si një kishë me 100 vetë që ka më shumë se 6 milion dollarë borxhe mund të kthehet në një kishë me 2000 vetë dhe me një buxhet vjetor prej më shumë se 2 milion dollarë, ai nuk iu ofron ndonjë skemë madhështore.

“Për shumë njerëz, kjo tingëllon tepër e thjeshtë”, thotë ai. “Por unë isha i vendosur që do të predikoja Jezusin dhe do t’i doja njerëzit. Jezusi tha: ‘Dhe unë, kur të jem ngritur lart nga toka, do t’i tërheq të gjithë tek unë’ (Gjoni 12:32). Unë i desha njerëzit pavarësisht nga kultura apo gjuha e tyre, dhe njerëzit erdhën nga çdo kulturë dhe çdo gjuhë. Por nuk isha vetëm unë. I gjithë stafi ynë ishte i vendosur për të arritur çdonjërin dhe të gjithë”.

Perëndia e nderoi fokusin e QKN-së. Hoxhins beson se ishte një takim hyjnor ai që e drejtoi një sipërmarrës vendor në fushën e ndërtimit që të blinte pronën prej 20 mijë metra katrorë të kishës për 6 milionë dollarë, dhe më pas t’i shiste kishës parcelën e tokës bashkë me ndërtesën e saj për 2.6 milionë dollarë para se ta përdorte pjesën tjetër të tokës për ndërtime të mëtejshme. Ky sipërmarrës madje doli garant duke firmosur kredinë e re të QKN-së.

Sot, njerëz nga e gjithë bota marrin pjesë në tri shërbesa në gjuhën angleze të dielave në mëngjes dhe një shërbesë në spanjisht të dielave në mbrëmje.

Hoxhins thotë: “Ne punojmë shumë për ta mbajtur këtë kishë. Ne nuk e ndajmë

në dy pjesë bashkësinë: bashkësia spanjisht-folëse dhe bashkësia anglisht-folëse. Thjesht kemi shërbesë në spanjisht ose në anglisht, por që të gjithë jemi një bashkësi e vetme”. Hoxhins beson se Perëndia e shpëtoi QKN-në për të ndikuar qytetin e Nju Jorkut dhe botën.

“Sa prej njerëzve tanë janë kthyer në Haiti, apo Xhamajkë, apo Bangladesh dhe kanë prekur jetët e njerëzve që jetojnë atje? Ne po i prekim edhe ato jetë gjithashtu në mënyrë indirekte”, thotë ai.

Vitet e fundit Hoxhins ka shërbyer edhe vetë ndërkombëtarisht. Ai përmend një seminar të planifikuar në Bangladesh për pastorët dhe punëtorët e kishës. Për të, kjo do të jetë vizita e tij e katërt.

“Unë besoj se adhurimi dhe predikimi i vajosur dhe dashuria për të gjithë njerëzit do ta ndërtojë kishën”, thotë ai. “Ende i ndjej qimet e flokëve që më ngrihen përpjetë sa herë që tregoj historinë se çfarë ka bërë Perëndia për ne”.

SCOTT HARRUP,
është redaktori
menaxhues për
revistën *Pentecostal
Evangel, Springfield,
Misuri.*



TREGIME NGA SHKRIMI RRETH ETNOCENTRIZMIT DHE PËRQASJEVE RIPARUESE

Forcat etnocentrike janë të fuqishme, siç ilustrohet nga shembulli i sjelljes ngurruese të Pjetrit kur atij iu dha privilegji për t’iu hapur dyert johebrenjve në Cezare (Veprat 10). Ishte e nevojshme që i njëjti vegim të përsëritej tri herë, bashkë me ftesën për të ngrënë një vakt me ushqime të papastra, për shkak se pa këtë vegim do të kishte qenë shumë e vështirë që Pjetri ta pranonte këtë detyrë.

Johebrenjtë konsideroheshin nga hebrenjtë si të padëshiruar, të papastër dhe si të pazgjedhur. Si të tillë, ata ishin të dëbuar nga Mbretëria. E megjithatë, siç shprehet në Shkrim, Perëndia kishte plane të tjera. Perëndia përcaktues i ka thirrur të gjitha kombet dhe fiset për të qenë pjesë e popullit të Tij, dhe ajo të cilën Perëndia e ka pastruar nuk duhet të quhet e papastër, madje as nga një apostull.

Për të ilustruar edhe më tej qëndrimin etnocentrik të mbajtur nga ata që e konsideronin veten e tyre se i kishin punët mirë me Perëndinë, Veprat 10:14 paraqet përgjigjen nga Pjetri: “Kurrresi, o Zot” (Nëse

ju thoni jo, Ai nuk është Zot; nëse Ai është Zot, ju nuk mund të thoni jo). Justifikime të mëtejshme, që i përafrohen një deklaratë neverie, janë regjistruar në takimin e parë midis apostullit dhe Kornelit, një kryeqindësi romak (Veprat 10:27-29). Pavarësisht qëndrimit dhe sjelljes fillestare të Pjetrit, Perëndia e ndërpreu në mënyrë të hirshme predikimin e tij duke e pagëzuar Kornelin dhe të gjithë anëtarët e shtëpisë së tij me Frymën e Shenjtë, e cila ishte një shfaqje e gjallë dhe e zëshme që imitonte përvojën origjinale të ditës së Rrëshajave në mesin e të gjithë dishepujve hebrenj në Jerusalem (Veprat 10:44-46). Më vonë, Pjetri, tashmë i bindur, do të mbronte, në këshillin e parë të kishës në Jerusalem, të drejtën e johebrenjve për të qenë pjesë e premtimeve dhe e përfitimeve të Mbretërisë (Veprat 15).

Lejojeni Frymën e Shenjtë që të ripërkufizojë, në mendjen tuaj, realitetin ndërkulturor i cili është tashmë i përkufizuar nga Perëndia.

Këshilli i parë u mbledh për të adresuar sfidat e marrëdhënieve ndërkulturore që u parashtuan në trupin e Krishtit. Përpjekjet e Palit, Barnabës, Silas dhe bashkëpunëtorëve të tjerë në punën e tyre misionare patën rezultate pozitive, dhe një numër i madh johebrenjsh iu shtuan kishës.

Mënyra se si të krijoheshin lidhjet me johebrenjtë e konvertuar dhe çfarë duhej të bëhej me ta, u kthye në sfidën e parë me të cilën u përball bashkësia ndërkulturore dhe ndëretnike. Kur u shfaqën mospërputhjet, kjo çoi në ndërlikime dhe tensione. Përpjekja e parë për të zgjidhur këto lloj ndryshimesh ishte përmes bërjes së johebrenjve si vetja e tyre. Dhe kështu, diskutuan se çfarë duhej bërë për të asimiluar, përshtatur dhe ekuilibruar larminë që parashtonte një sfidë e tillë. E megjithatë, propozimi për t'i ngjeshur johebrenjtë brenda një modeli hebre u anulua nga Fryma e Shenjtë, i cili, përmes një fjale urtësie, shpalli se këta besimtarë të etnive të ndryshme duhej të pranoheshin dhe të trajtoheshin me dinjitet në Trupin e Krishtit, po qe se do të ndiqnin direktivat për të shmangur sjelljet që ishin ofenduese për hebrenjtë. Këta shembuj të pakët nga Shkrimi

mund të vendosin kushtet për rrugën e veprimeve që edhe ne mund të ndjekim sot (Veprat 15:5–21).

PËRMBYLLJE

Me qëllim që të përjetojmë dhe të bëjmë realitet marrëdhënie të përzemërta dhe dashamirëse në kontekstin e një kishe të shëndetshme, na duhet të jemi imitues të Perëndisë si fëmijë të dashur, si dhe të ecim në dashuri, ashtu siç na deshi Krishti dhe dha veten e Tij për ne (Efesianëve 5:1, 2). Duke bërë këtë, ne e zhvillojmë **veten tonë të vërtetë sipas përkufizimit të Perëndisë** (identiteti në Krishtin). Për më tepër, zhvillojmë **një person të shëndetshëm që ka marrë formë nga Fryma e Shenjtë** (integriteti). Kështu, jemi në gjendje ta ndajmë veten tonë **me dashuri dhe përkujdesje, në mënyrën e duhur** (intimiteti), duke bërë çdo përpjekje për të arritur synimet e Perëndisë **në marrëdhënie kuptimplota** (puna me zell).

BURIMET

Crabb, Larry. 1997. *Connecting: Healing Ourselves and Our Relationships* (Lidhje: Shërimi i Vetes dhe i Marrëdhënieve Tona). Nashville: W. Publishing Group.

Kraft, Charles, dhe Marguerite Kraft. 2005. *Christianity in Culture: A Study in Dynamic Biblical Theologizing in Cross-cultural Perspective* (Krishterimi në Kulturë: Një Studim në Teologjizimin Dinamik Biblik tek Perspektiva Ndërkulturore). Maryknoll, New York: Orbis Books.

Lingenfelter, Sherwood G. 1996. *Agents of Transformation: A Guide for Effective Cross-cultural Ministry* (Veprimtarë të Transformimit: Një Udhëzues për Shërbesën Efektive Ndërkulturore). Grand Rapids: Baker Book House.

Polischuk, Pablo. 2004. *Llamando las Cosas por su Nombre* (T'i Quajmë Gjërat me Emrin e Vet - Calling It What It Is). Miami: Vida.



PABLO POLISCHUK, Ph.D.

është pedagog i këshillimit pastoral dhe i psikologjisë në seminarin teologjik "Gordon-Conwell", South Hamilton, Masaçusets.



*për Gratë
në Shërbesë*

Të ndryshëm - POR NË FAMILJEN E TIJ

Nga: **MARCIA LEDNICKY**



Përgjatë gjysmë-shekullit të fundit, ka qenë një privilegj

i madh për mua të kem qenë në shumë zona të ndryshme të botës dhe të përjetoja kultura të ndryshme. Secili komb ka një lloj aspekti që është unik për atë komb që e dallon atë nga kulturat e tjera. Kur Fryma e Shenjtë na drejtoi para disa vitesh për të qenë pastorë të Kishës Ndërkombëtare në Bangkok të Tajlandës, pasi kishim shërbyer më herët në rreth gjashtëdhjetë kombe të botës, ne ishim në gjendje të identifikoheshim me pothuajse çdo grup njerëzish në bashkësinë tonë. Një nga aspektet më shpërblyes të asaj shërbese ishte që të ndihmonim njerëz nga shumë kombe të ndryshme, si ato që janë larg gjeografikisht, ashtu edhe ato që janë ndryshe nga ana kulturore, për të kuptuar më së miri dhe për të pranuar një kulturë e cila ishte, në shumë mënyra, gati e kundërta e kulturës së tyre.

Më kujtohet veçanërisht një ditë kur ishim duke u kënaqur në takimin tonë të grave (të cilin e quanim "bashkësi me gëzim"). Kjo ishte gjithmonë një kohë e fuqishme gjatë së cilës ne ngazëllenim në Zotin dhe inkurajonim njëra-tjetrën në besim. Ne ishim duke kënduar së bashku refrenin e një kënge kur Fryma e Shenjtë filloi të lëvizë në mesin tonë. Një nga gratë afrikane filloi të ngazëllej në një mënyrë që është unike për kulturën e saj afrikane. Duke qenë shumë herë më parë në Afrikë, isha në gjendje që t'u flisja edhe të tjerëve në lidhje me çiltërsinë e adhurimit dhe të këndimit të tyre. Unë po u tregoja se sa e mrekullueshme do të jetë kur grupet e njerëzve nga e gjithë bota do të vijnë së bashku në praninë e Zotit. Mundem vetëm ta imagjinoj se çfarë kori i harmonishëm do të krijohet për të adhuruar së bashku! Një nga aspektet më shpërblyes të asaj shërbese të caktuar ishte aftësia për të ndihmuar shumë grupe nga kultura të ndryshme që të kuptonin, të pranonin dhe të donin vëllezërit dhe motrat në Krishtin Jezus.

Meqenëse jam gruaja e një pastori, mua më janë dhënë shumë mundësi fantastike për të ndikuar në jetën e të tjerëve për të qenë më shumë si Krishti. Një ndër këto privilegje shumë të veçanta është aftësia për të pranuar me dashuri larminë që është në familjen e besimit, dhe përmes stilit tuaj të jetesës dhe rrugëtimit të besimit t'u tregoni të tjerëve zemrën e Perëndisë dhe t'u mësoni atyre parimet e Fjalës së Perëndisë. Kur Jezusin e pyetën rreth urdhërimit më të madh, ai u përgjigj: *"Duaje Zotin, Perëndinë tënd me gjithë zemrën tënde, dhe me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde". Ky është urdhërimi i parë dhe i madhi. Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: "Duaje të afërmin tënd porsì vetveten". Nga këto dy urdhërime varet i tërë ligji dhe profetët"* (Mateu 22:37-40).

Menjëherë pas derdhjes fillestare të Frymës së Shenjtë në Ditën e Rrëshajave, shumë vetë e zgjatën qëndrimin e tyre në Jerusalem. Mes tyre kishte edhe të veja judease që ishin greqishtfolëse, të cilat jetonin larg Jerusalemit. Në një periudhë të shkurtër kohe pas Rrëshajave, ekzistonte një pështjellim në mesin e të vejave që po merrnin përkujdesje nga kisha e hershme. Të vejat judease greqishtfolëse u ankuan që të vejat që flisnin hebraisht, të cilat ishin banore në Jerusalem, po merrnin racione më të mëdha ushqimore (Veprat 6). Kjo mund të ketë sjellë shumë pështjellim tek njerëzit dhe mund ta ketë penguar shumë punën e Perëndisë. Por apostujt, të mbushur me urtësi të dhënë nga Perëndia, i mblodhën të gjithë besimtarët bashkë për ta konsideruar në lutje këtë situatë. Pas shumë lutjesh, përgjegjësia për shpërndarjen e përditshme të ushqimit iu dha shtatë

burrave, të cilët ishin shumë të respektuar, të mbushur me Frymën e Shenjtë dhe të pajisur me urtësi të dhënë nga Perëndia (Veprat 6:2-7). Mesazhi i Perëndisë vazhdoi të përhapej dhe nuk u pengua nga pështjellimi që u krijua për shkak të larmisë në kishën e re të Dhjatës së Re. Paragjykimi i hapur është shpeshherë rezultati i mungesës së gatishmërisë për të pranuar atë që është ndryshe tek të tjerët.

Përgjegjësia e udhëheqjes nuk duhet marrë asnjëherë lehtësisht. Kur jeni duke u marrë me njerëz, sidomos me njerëz nga kultura të ndryshme, sfonde të ndryshme dhe standarde të ndryshëm ekonomikë, është shumë e lehtë që të zhvillohen situata të vështira. Prandaj, është e një rëndësie të madhe që të jemi të mbushura me Frymën e Shenjtë, të kalojmë kohë duke u lutur dhe të mbështetemi tek urtësia e dhënë nga Perëndia. Në fakt, kjo është jetike për avancimin e vazhdueshëm të mesazhit të ungjillit. Duhet të jemi gjithmonë të vetëdijshme ndaj skemave dhe natyrës shkatërruese të armikut të Perëndisë. Në qoftë se ne e lejojmë satanin, që përmes konfliktit të brendshëm, të na shpërqendrojë nga misioni i përjetshëm që i është dhënë trupit të Krishtit, atëherë ai ka arritur një fitore të madhe.

Një tjetër shembull biblik na jepet tek Veprat e Apostujve 10. Korneli, një ushtarak romak, ishte një burrë që kishte frikë nga Perëndia. Një ditë, ndërsa ai po lutej, Perëndia i dha një vegim dhe i tha, në mënyrë specifike, të dërgonte njerëz në Jopa për të thirrur në shtëpinë e tij një njeri me emrin Simon Pjetër. Të nesërmen, burrat shkuan dhe e gjetën Pjetrin. Ndërkohë që ai po lutej, Perëndia e udhëzoi apostullin, përmes një mënyre dramatike, që të shkonte me këta burra. I shoqëruar nga gjashtë prej vëllezërve nga Jopa, Pjetri shkoi në shtëpinë e Kornelit, i cili kishte mbledhur bashkë të afërmit dhe miqtë e tij më të ngushtë, dhe ata ishin duke pritur me padurim që të dëgjonin mesazhin që Zoti kishte për ta. Pjetri u përgjigj: *"Në të vërtetë po e marr vesh se Perëndia nuk tregohet i anshëm... Ndërsa Pjetri ende po i thoshte këto fjalë, Fryma e Shenjtë ra mbi të gjithë ata që po e dëgjonin fjalën. Dhe të gjithë besimtarët, që ishin të rrethprerë, të cilët kishin ardhur me Pjetrin, u mrekulluan që dhurata e Frymës së Shenjtë u derdh edhe mbi kombet"* (Veprat e Apostujve 10:34, 44-45). Pjetrit i duhej t'u shpjegonte krerëve në Jerusalem veprimet e tij, pra, që kishte shkuar në shtëpinë e një johebriu; megjithatë, ata e kuptuan shumë shpejt se Perëndia nuk e konsideron kombësinë si një parakusht për të qenë i shpëtuar dhe i mbushur me Frymën e Shenjtë.

Ka mjaft mësimë të fuqishme që mund të nxirren nga Fjala e Perëndisë mbi këtë temë.

1

Vazhdimisht ne nxitemi që të kuptojmë se çdo lloj paragjykimi është jobiblik. Duke iu referuar edhe një herë viteve që ne kaluam në Bangkok, më kujtohen rastet kur dëgjonim për njerëzit dhe kulturat që kategorizoheshin në një mënyrë apo një tjetër nga njerëz që ishin nga një kombësi tjetër. Duket sikur kudo ku shkon në botë, njerëzit kanë paragjykime kundër kombeve, grupeve të njerëzve dhe kulturave të tjera.

Para shumë vitesh, ishim duke drejtuar një skuadër të rinjsh në një udhëtim misionar në Evropë. Ndërsa po njiheshim me anëtarët e një skuadre që po na bashkohej, të cilët ishin nga një kombësi tjetër, një djalosh më thotë: “Në rast se më fusni në një dhomë me një mijë njerëz dhe brenda saj është një amerikan, unë mund ta gjej atë”. “Po, si?” e pyeta unë. Ai tha: “Po, sepse ata janë shumë arrogantë”.



Dhe unë kësaj iu përgjigja: “Më vjen shumë keq që mendon në këtë mënyrë, sepse unë besoj që Krishti bën një ndryshim në çdo jetë”. Jam e bindur se edhe shprehja e fytyrës së një personi reflekton Frymën e Perëndisë që jeton brenda atij personi.

Një ditë, herët në mëngjes, po ktheheshim në Amerikë pas një fluturimi ndërkombëtar shumë të gjatë. Kishim fluturuar me aeroplan për një pjesë të ditës së mëparshme dhe pastaj gjithë natën. Mund ta imagjinoni pak se si dukeshim. Ishim të lodhur, veshjet i kishim të rrudhosura, etj. E keni parasysh besoj. Ndërsa ishim tek shkallët e lëvizshme duke u drejtuar për tek dalja e aeroportit, vumë re një burrë që po qëndronte në majë të shkallëve dhe po shpërndante trakte të ungjillit. Kur zbritëm nga shkallët, ky burri nuk na dha asgjë, përkundrazi,

zgjati dorën dhe me një buzëqeshje të ngrohtë, na tha: “Sa mirë që po shoh besimtarë të tjerë”. Ne nuk e njihnim këtë vëlla dhe madje as nuk e kishim parë ndonjëherë më parë! Unë dhe bashkëshorti im ishim kaq falënderues dhe të përlur nga fakti se edhe pse paraqitja jonë e jashtme nuk ishte aspak e përsosur, fryma jonë dhe shprehja e fytyrës rrezatonte Frymën që ishte brenda nesh. Prandaj, kultura, arsimi, etnia apo statusi ekonomik nuk ka aspak lidhje me marrëdhënien që ne kemi me Krishtin dhe me kishën e Tij.

2

Dashuria e vërtetë biblike kërkon përpjekje të qëllimta për t'i përqafuar të tjerët edhe pse ata mund të mos jenë si ne. Nga pikëpamja realiste, është shpesh e vështirë që të mos jemi gjykues ndaj atyre që vishen, sillen apo flasin ndryshe nga ne. Më lejoni të përdor vendin tim si shembull për të

shpjeguar një pjesë të fjalisë së mësipërme. Unë vij nga pjesa jugore e Amerikës dhe kam qenë pjesë e asaj “kulture” gjithë jetën time. Njerëzit që janë nga Jugu në përgjithësi kanë prirjet për të qenë shumë miqësorë, shumë të shoqërueshëm dhe i shprehin shumë hapur dashamirësinë dhe ndjenjat e tyre. Me këtë të fundit dua të them se është shumë e natyrshme për ne që, kur takohemi me dikë që e njohim mirë, ta përqafojmë. Ose, nuk është e pazakontë që gjatë bisedës të mund ta prekim dikë tek krahu. Nga ana tjetër, një individ nga pjesa veriore e SHBA është i prirur për të qenë pak më i përmbajtur. Për dikë që ka një sfond historik nga pjesa jugore e vendit kjo sjellje mund të duket si e ftohtë, ose jo miqësore. Por me këtë nuk dua të supozoj se njëra është e drejtë dhe tjetra gabim. Ky është thjesht një ilustrim për të treguar dallimet kulturore, madje brenda të njëjtit komb.

Duke qenë bashkëshorte e njëpastori, ose në fakt duke qenë besimtare, përpjekja për të kuptuar kombin apo rajonin prej nga vjen një person i caktuar, do të na ndihmojë t'i kuptojmë dhe t'i pranojmë më lehtësisht ata. Ja një shembull tjetër i larmisë kulturore: Në zonën e SH.B.A-së, ku unë kam jetuar, kur një fëmijë ose adoleshent i drejtohet një të rrituri vetëm me emër, kjo do të konsiderohej si mungesë edukate, sepse gjithmonë kur t'i drejtoheshin do të përdornin titujt *zoti* ose *zonja*. Në zona të tjera të vendit, ndoshta kjo do të konsiderohej gabim nëse një të rrituri nuk i drejtohen me emër. E di që kjo nuk ishte e ndonjë rëndësie të veçantë, por unë duhet të zgjidhja qëllimisht që të mos tregohesha gjykuese kundrejt atyre që më thërrisnin vetëm me emër, por që ishin më të rinj në moshë se unë, veçanërisht fëmijë. Unë kuptova se

ata nuk po tregonin mungesë edukate me dashje; përkundrazi, kjo ishte thjesht pjesë e kulturës së tyre. Ndonjëherë larmia kulturore mund të jetë goxha sfidë. Edhe një shembull të fundit: Në kulturën tonë, konsiderohet e pasjellshme kur pyesim dikë për moshën e tyre. Megjithatë, në shumë kultura njerëzit nuk hezitojnë aspak të pyesin për moshën e personit apo të bëjnë ndonjë pyetje tjetër personale. Ju lutem më falni që po përdor përvoja personale, por shpresoj që ato do t'ju ndihmojnë të kuptoni më mirë se si normat kulturore mund të kthehen në probleme, madje edhe në mesin e besimtarëve. Prandaj, të dashura gra, në qoftë se kuptojmë një individ, sfondin e tyre historik, kombësinë apo madje edhe jetën e tyre në shtëpi, atëherë kjo do të jetë ndihmë për ne që t'i duam me hir të gjithë njerëzit, ashtu siç i deshi dhe vazhdon t'i dojë edhe sot Jezusi.

3

Preferencat dhe stilet nuk duhet të jenë themeli për bashkësi në mesin e besimtarëve. Kur mbledhemi tek këmbët e Jezusit, mund të çuditemi shumë me gjërat që janë vërtet të rëndësishme dhe me ato që nuk janë edhe aq domethënëse. Ka raste që pështjellimi zhvillohet atëherë kur janë preferencat, dhe jo Shkrimi, ato që përcaktojnë se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar. Kjo është e vërtetë veçanërisht kur zgjedhim stilet e muzikës. Cila është çështja e vërtetë? A i sjell lavdi Perëndisë? A po i shkon vëmendja një individi apo një grupi, apo po përqendrohet tek Ati qiellor? Pra, edhe një herë, ndërsa udhetojmë nga njëri vend në tjetrin, stilet e adhurimit mund të jenë jashtëzakonisht të ndryshme. Unë vetëm sa mund ta imagjinoj se si do të duket parajsa. Në rast se jeni kaq shumë të bekuara sa të keni kombe të ndryshme apo grupe të ndryshme njerëzish që përfaqësohenatë ku ju adhuroni, atëherë jini mirëkuptuese dhe i ndihmoni të tjerët të mos gjykojnë zemrën e dikujt nëpërmjet stilit të tij ose të saj të adhurimit.

Të dashura gra, jini të përqendruara tek fakti se ardhja e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë të mrekullueshëm mund të jetë nga çasti në çast. Jini të vetëdijshme se armiku po kërkon çdo mundësi që të sjellë pështjellim në mesin e popullit të Perëndisë. Megjithatë, është e rëndësishme që gjithmonë t'u bindemi me kujdes parimeve dhe të vërtetave të Fjalës së Perëndisë. Në qoftë se diçka e cila është e pranueshme në cilëndo kulturë bie ndesh me parimet e Shkrimit, atëherë, patjetër, duhet ta refuzojmë atë, ashtu siç na mësohet në Fjalën e frymëzuar të Perëndisë.



Le të kujtohem edhe njëherë të gjitha se sa i rëndësishëm është vendi i shërbesës që ju zini në detyrën e ndërtimit të mbretërisë së Perëndisë. Për shkak të pozitës suaj, që është shumë e dukshme, anëtarët e kishës i kanë sytë tek ju. Ata do të vëzhgojnë me kujdes reagimet tuaja në çdo situatë të caktuar. Ata shohin se si reagoni ju ndaj personit që nuk ka marrë kurrë më parë pjesë në vendin ku ju adhuroni, dhe mund të duket goxha ndryshe në një ose në shumë mënyra. Inkurajojini të tjerët që t'i duan njerëzit. Inkurajojini gratë që të shkojnë përtej rrethit vetjak të mikeshave dhe të investojnë në jetët dhe nevojat e të tjerëve. Lutja ime ka qenë shpeshherë kjo: "O Zot, duaji të tjerët përmes meje; lejo që të jem unë dora jote që i zgjatet një bote të humbur". Dhe, ndërkohë që ju udhëhiqni në mënyrë frymërore nga një pozicion ndikues, lehtësisht i dukshëm, atëherë të tjerët do t'ju ndjekin. Çdo ditë, Zoti ynë i mrekullueshëm, siguron mundësi të shumta për ta përfaqësuar Atë në këtë botë, dhe që të tregojmë shtegun drejt një jete fituese me gëzim dhe paqe.

Çfarë privilegji i bekuar!



MARCIA LEDNICKY është një folëse e shpeshtë në seminare e konferenca për femra. Ajo ka një aftësi unike për t'i lidhur sfidat e jetës së përditshme me të vërtetat e Shkrimit. Shërbesa e saj e të folurit në publik rritet me anë të talentit të saj vokal të jashtëzakonshëm përmes të cilit ajo komunikon dhe transmeton dashurinë e Krishtit.

Të përqafojmë pasionin
e Perëndisë për
Diversitetin:

Një teologji e
pluralizmit racor
dhe etnik



Nga: CRAIG S. KEENER



Është e nevojshme që të lutemi rregullisht që vullneti i Perëndisë të bëhet në tokë si në qiell. Si do të dukej kjo? Një nga mënyrat se si do të dukej, është si një unitet shumëracor dhe shumetnik në larminë e kulturave. Për të gjitha epokat e përjetësisë, populli i Perëndisë nga çdo komb do të adhurojnë së bashku përreth fronit (Zbulesa 5:9; 7:9). Perëndia mund ta përdorë kishën e Tij, si trashëgimtarë të Mbretërisë, për të kumtuar se si do të jetë bota e ardhshme. Adhurimi shumëracor dhe shumetnik është pjesë e shijimit tonë paraprak të parajsës.

Në vitin 2006, pentekostalët dhe karizmatikët përkujtuan njëqind vjetorin e Rizgjimit të Rrugës Azusa. Që prej fillimit, një nga karakteristikat e këtij rizgjimi, të udhëhequr nga pastori afrikano-amerikan, William J. Seymour, ishte karakteri i tij ndër-racor. Krijimi shumëracor i lëvizjes moderne pentekostale nuk duhet të na çudisë, duke pasur parasysh të njëjtin mesazh ditën e parë të Rrëshajave.

BABELI MORI KUPTIM TË KUNDËRT NË DITËN E RRËSHAJAVE

Në ditën e parë të Rrëshajave për kishën, Perëndia filloi të përmbushë premtimin e Tij të kohëve të fundit për të frymëzuar popullin e Tij që të fliste për Të (Veprat e Apostujve 2:17,18), por si fillim ata folën në gjuhët e njerëzve të tjerë (Veprat e Apostujve 2:4-6). Gjatë këtij rasti, hebrenjtë që vinin nga kombe të ndryshme i njohën shumë prej gjuhëve vendore që po fliteshin (Veprat e Apostujve 2:9-11).

Shumë studiues vërejnë se lista e vendeve prej nga vinin shumë prej këtyre hebrenjve duket shumë e ngjashme me listën e kombeve tek Zanafilla 10 (përveç faktit që përshkruhen me gjuhën e shekullit të parë). Tek Zanafilla 11, Perëndia i shpërndau këta njerëz tek kulla e Babelit duke ua ngatërruar gjuhët. Ditën e Rrëshajave, në kontrast me kullën e Babelit, Perëndia siguron sërish një larmi gjuhësh, por jo për të ndarë njerëzimin. Këtë herë, përmes dhuntisë së re të gjuhëve, Perëndia mbledh së bashku një kishë të bashkuar në mesin e shumë kulturave, duke kumtuar pjesën tjetër të planit të Tij tek Veprat e Apostujve.

Sa thelbësore është çështja e unitetit shumëracor dhe shumetnik për të kuptuar atë që ndodhi ditën e Rrëshajave? Mbani mend premtimin e Jezusit: Fryma do të na fuqizojë për të qenë dëshmitarë deri në skajet e dheut, që do të thotë, të jemi dëshmitarë ndërkulturore (Veprat e Apostujve 1:8). Kaq thelbësore është dëshmia ndërkulturore ndaj këtij fuqizimi të Frymës sa që Perëndia zgjodhi ta konfirmonte atë, duke përdorur si shenjë specifike, shërbëtorët e Tij që adhuronin në gjuhët e njerëzve të tjerë. Prandaj nuk është për t'u habitur që prej Rrugës Azusa e deri më tani, misioni ka qenë një shenjë dalluese e lëvizjes pentekostale. Si rrjedhojë, një pjesë e mirë e botës së krishterë sot i shohin pentekostalët si një model të misionit efikas.

Për të gjitha epokat e përjetësisë, populli i Perëndisë nga çdo komb, do të adhurojnë së bashku përreth fronit (Zbulesa 5:9; 7:9).

PAK VIZIONARË DHE SHUMË NXËNËS TË NGADALTË

Megjithatë, thjesht për shkak se Fryma na ka fuqizuar për të qenë një urë mes ungjillit dhe të gjitha kulturave, racave dhe grupeve etnike, nuk do të thotë se do ta kuptojmë dhe që do ta shfrytëzojmë automatikisht fuqinë që Ai na ka dhënë. Shumica e kishës në Jerusalem ishte e ngadaltë për t'i rënë në të e për ta zbatuar planin e Perëndisë.

Ata që e rrokën vizionin të parët ishin të krishterët hebrenj helenistë, të cilët ishin një minoritet kulturor brenda kishës në Jerusalem. Për shkak se ata ishin tashmë të njohur me më shumë se një kulturë, kishin një lloj ndjeshmërie ndaj dinamikave të shërbesës ndërkulturore. Filipi, një nga predikuesit helenistë, i hapi rrugë misionit të kishës në Samari (Veprat e Apostujve 8:5-13). Pasi apostujt nga Jerusalemi mbërritën atje dhe e panë se puna ishte nga Zoti, atëherë edhe ata iu bashkuan këtij misioni (Veprat e Apostujve 8:25). Por token e re e kishte hapur Filipi.

Pas rizgjimit në Samari, Perëndia e dërgoi Filipin të takojë me një zyrtar të rëndësishëm nga Etiopia (Veprat 8:26-39). Ky zyrtar, i cili duke qenëse ishte eunuk dhe nuk mund të bëhej plotësisht një hebre, u kthye në të krishterin e parë johebre. Konvertimi i tij nuk nxiti asnjë polemikë. Për shkak se ai u kthye në atdheun e tij, me sa duket kisha në Jerusalem nuk e mori vesh historinë e tij; gjithsesi, ai nuk jetonte në vendin e tyre dhe nuk do të vendoste ndonjë precedent të parehatshëm.

Por, përqafimi i johebrenjve të parrethprerë, në mënyrë të pashmangshme do të shkaktonte polemika. Shumë shpejt Perëndia dërgoi Pjetrin tek Korneli, i cili qe një zyrtar në ushtrinë romake që kishte pushtuar Judenë. Pavarësisht udhëzimeve të Jezusit për të qenë dëshmitarë deri në skajet e dheut, Pjetri pati nevojë për një vegim dramatik për ta transformuar perspektivën e tij rreth johebrenjve (Veprat e Apostujve 10:28,29). Pasi mësoi se edhe Korneli kishte pasur një vegim paralelisht me të, dhe pasi ishte dëshmitarpër derdhjen e Frymës në shtëpinë e tij, Pjetri dhe shokët e tij kuptuan se Perëndia i kishte pranuar këta johebrenj (Veprat e Apostujve 10:44-48). Kisha në Jerusalem e pranoi se Perëndia po mirëpriste gjithashtu edhe johebrenjtë, vetëm pasi Pjetri numëroi konfirmimet e shumta të planit të Perëndisë (Veprat e Apostujve 11:18).



Le të ulen kori dhe orkestra në sallë, që të vazhdojmë me predikimin tani...

REAGIMI I FORTË TRAGJIK

Pranimi që Perëndia i bëri një grushti të konvertuarish johebrenj shkaktoi në kishën e Jerusalem it një nivel të ulët shtangieje, për atë kohë sa ata do të qëndronin vetëm një grusht, që do të thotë, për atë kohë sa ata mund të shiheshin si **përrjashtime**. Por, raportimet e një numri të madh të konvertuarish të parrethprerë i rriti rrethimin.

Mësimet hebraike insistonin se johebrenjtë që konvertoheshin në judaizëm duhej të rrethpiteshin. Në rast se ndjekësit e Jezusit në Jerusalem nuk do të arrinin të ngulnin këmbë mbi të njëjtin kusht, atëherë kjo do të bënte ata që të dukeshin keq para bashkëkombësve të tyre. I përballur me një shtypje të vazhdueshme nga johebrenjtë, me një perandor të çmendur i cili u përpoq të përdhoste tempullin dhe me një mbretërim të shkurtër të një mbreti hebre i cili nxiti entuziazmin nacionalist, Jerusalemi filloi të bëhej më konservator gjatë viteve 40-të, 50-të dhe 60-të të shekullit të parë. Në shumicën e kulturave, kisha pasqyron shoqërinë e saj si pozitivisht ashtu edhe negativisht, dhe kisha në Jerusalem nuk përbënte përjashtim për këtë gjë. Disa persona filluan të ngulnin këmbë në rrethprerjen e të konvertuarve johebrenj (Veprat e Apostujve 15:1,5; krahasoni Galatasve 5:11; 6:12). Por edhe në historinë e

kohëve të fundit, kishat që dërgojnë misionarë shpeshherë e ngatërrojnë kulturën e tyre me ungjillin dhe ngulin këmbë që të konvertuarit e huaj të konformohen me kulturën e kishës dërguese.

Kështu, kisha debatoi përsëri nëse do t'i mirëpriste ose jo plotësisht johebrenjtë si johebrenj, pa u kërkuar atyre të hiqnin dorë nga kultura e tyre. Pali dhe Barnaba i numëruan konfirmimet e Perëndisë për shërbesën e tyre me shenja; Pjetri i kujtoi kishës episodin që ai pati më herët me Kornelin dhe Jakobi e mbylli me një argument nga Shkrimi (Veprat e Apostujve 15:7-21), duke shpëtuar përsëri unitetin e kishës.

E megjithatë, nacionalizmi vazhdoi të rritej në Jerusalem dhe e përshkallëzoi tensionin midis kishës në Jerusalem dhe kishave të reja që ishin jashtë Tokës së Shenjtë. Pali kishte për qëllim që vizita e tij e fundit në Jerusalem të ishte një porosi për paqe, dhe solli me vete përfaqësues nga diaspora të kishave të përziera hebreo-johebreje, bashkë me një ofrim për të krishterët e varfër të Jerusalemit. Shumë shpejt ai mësoi se disa besimtarë kishin pranuar fjalë të rreme që thuheshin për të. Disa persona kishin dalë në përfundimin se në qoftë se Pali respektonte kulturën e johebrenjve, atëherë duhet të refuzonte kulturën judease (Veprat e Apostujve 21:21). Pali ra dakord të demonstronte identifikimin që ai kishte me kulturën e vet judease si një mënyrë për t'i davaritur këto thashetheme të rreme (Veprat e Apostujve 21:23-26).




Megjithatë, në mes të porosisë së Palit për pajtim, disa njerëz që e kundërshtonin misionin e tij ndërkohë johebrenjtë e sulmuan (Veprat e Apostujve 21:27-29). Në këtë atmosferë armiqësore, Pali bëri edhe një përpjekje të fundit për të shpjeguar misionin e tij. Turma që ishte në tempull dëgjonte ndërkohë që ai shpalli Jezusin. Çdokush do të kishte shpresuar për një reagim të madh ndaj shpëtimit siç pati Pjetri në tempull një brez më parë. Megjithatë, duke pasur parasysh thirrjen e Palit, ai nuk mund të reshte së foluri për Jezusin. Ata që e përqafojnë me të vërtetë ungjillin bëhen pjesë e kishës së Perëndisë, dhe anëtarët e vërtetë të kishës së Perëndisë duhet të mirëpresin anëtarë të tjerë të kishës së Perëndisë. Kështu Pali foli për thirrjen e tij për të arritur johebrenjtë (Veprat e Apostujve 22:21) dhe e tërhoi menjëherë audiencën e tij dhe rindezi trazirat (Veprat e Apostujve 22:22). Ajo që audienca e Palit nuk dinte, ishte se fjalimi i tij ishte ndoshta shansi i fundit i tyre për një çlirim kombëtar. Një kishë e bashkuar me hebrenj dhe johebrenj ishte e vështirë për t'u arritur, por drejtimi alternativ i nacionalizmit të inatosur do të çonte në shkatërrimin e Jerusalemit vetëm disa vite më vonë. Mega-kisha e Jerusalemit, në mënyrë të lavdërueshme, po e arrinte me efikasitet kulturën e vet (Veprat e Apostujve 21:20); por mosbesimi i tyre për misionin ndaj johebrenjve ishte dritëshkurtër. Në planin e Perëndisë, kishat e reja me probleme, të diasporës, ishin fara e së ardhmes.

NJË MODEL NDRYSHË

Jerusalemi ishte pothuajse ekskluzivisht judaik, prandaj nuk mund të presim që kishat e tij të ishin bërë shumetnike, megjithëse do të kishte qenë e dobishme po të kishte më shumë vlerësim për kishat e tjera që ishin shumetnike. Por situata ishte ndryshe në Antiokinë kozmopolitane. Aty, hebrenjtë, grekët, sirianët dhe grupe të tjera përbënin minoritetet, dhe po aty të krishterët helenistë, që ishin shpërndarë gjithandej, kapën vizionin e Frymës për të ungjillëzuar johebrenjtë (Veprat 11:19-21).

Ndërkohë që kisha në Antioki u kthye në një kishë shumetnike, ajo caktoi një skuadër udhëheqëse të larmishme, e cila do të ishte e ndjeshme ndaj nevojave të të gjitha grupeve që përfaqësoheshin në kishë. Sauli kishte lindur në Tars, por u rrit në Jerusalem (Veprat e Apostujve 22:3). Arsimi i tij dhe lidhjet që kishte, tregojnë se ai vinte nga një familje me pozitë, megjithëse nënshtetësia e tij romake e trashëguar ka shumë të ngjarë se mund të vinte nga paraardhës të cilët kishin qenë skllëvër të liruar.



Kisha në Antioki kishte një vizion për të ndërtuar një kishë shumetnike jo vetëm në Antioki, por edhe në mbarë botën.

Barnaba ishte një levit nga Qipro; Manaeni ishte rritur bashkë me Herodin tetrark; Luci ishte nga Kirena, që ishte një qytet kozmopolitan në Afrikën e Veriut i ndarë afërsisht midis grekëve, hebrenjve dhe afrikano-veriorëve. Simeonin e quanin “Niger”, një emër i zakonshëm romak, por një emër i cili, kur përdorej si nofkë, nënkuptonte fjalën “i zi”. Shumë studiues sugjerojnë se ai, ashtu si Luci, ishte nga Afrika e Veriut, dhe ndoshta të dy rridhnin nga afrikanë që ishin konvertuar në judaizëm (Veprat e Apostujve 13:1).

Kisha në Antioki kishte një vizion për të ndërtuar një kishë shumetnike dhe shumëracore jo vetëm në Antioki, por edhe në mbarë botën. Detyra ishte kaq e madhe sa vetëm besimi i frymëzuar nga Fryma do të kishte guxuar ta imagjinonte një gjë të tillë, pra, që të arrinin botën e njohur deri atëherë, me një popullsi prej rreth 100 milion njerëz, me vetëm një grusht johebrenjsh në mesin e tyre, të cilët madje besonin tek Perëndia i vetëm. Por kisha në Antioki ishte me të vërtetë një kishë e mbushur me Frymën. Ashtu si Fryma lajmëroi një kishë të larmishme ditën e Rrëshajave; që i tha Filipit të fliste me zyrtarin afrikan dhe Pjetrit të fliste me Kornelin (Veprat e Apostujve 8:29; 10:19); dhe konfirmoi mirëpritjen e Perëndisë për samaritanët dhe johebrenjtë duke u dhënë atyre Frymën (Veprat e Apostujve 8:14-17; 10:44-46), edhe këtu Fryma dërgoi Palin dhe Barnabën (Veprat e Apostujve 13:2,4). Ata ungjillëzuan Qipron dhe pjesën jugore të Azisë së Vogël. Në udhëtimin e tij të radhës, kur Pali u largua nga Troasi për në Filipi,

grekët dhe romakët e panë atë me idenë se ai po sillte një mesazh aziatik në Evropë. Por më e rëndësishmja, nga një perspektivë biblike, Perëndia po vazhdonte të sillte mesazhin e Tij universal tek të gjitha kombet.

Pali, i udhëhequr nga Fryma, ishte i gatshëm që ta përshtaste kulturën e tij për t’i arritur të gjithë njerëzit me të vetmin mesazh përtej - kulturor të Krishtit (1 Korintasve 9:19-23). Njësoj si mesazhi i tij i refuzuar në tempullin e Jerusalemit (Veprat 22:21,22), edhe letrat e tij ofrojnë një kuptim të qartë të rëndësisë që kishte uniteti shumetnik për thelbin e ungjillit të tij. Ndarja etnike më dominuese në kishën e kohës së tij mbeti përçarja midis hebrenjve dhe johebrenjve, një përçarje të cilën vetë Perëndia e kishte vendosur dikur në

histori. Duke vëzhguar se si ungjilli i Palit e kapërcen një përçarje që dikur ishte vendosur nga vetë Perëndia, kjo na fton neve të vëmë në zbatim të njëjtin ungjill për përçarjet e tjera që janë vendosur nga krenaria dhe egoizmi njerëzor.

UNITETI ETNIK DHE THELBI I UNGJILLIT TË PALIT

Në qoftë se jemi të tunduar që të pyesim veten nëse ka apo nuk ka rrjedhoja ungjilli për unitetin etnik dhe racor në kishën e Krishtit, nuk na duhet të shohim larg. Letra e Palit drejtuar shenjtorëve në Romë i adresohet një kishë të përçarë etnikisht. Disa vite më herët, perandori Klaud i kishte përjashtuar hebrenjtë nga qyteti i Romës. Të krishterët hebrenj, siç ishin Akuila dhe Priskila, ishin vendosur diku tjetër (Veprat e Apostujve 18:2). Për shkak të këtij përjashtimi, me shumë mundësi kisha në Romë përbëhej kryesisht me johebrenj për disa vite me radhë deri në vdekjen e Klaudit dhe kthimin e të krishterëve hebrenj. Bashkësitë e hebrenjve dhe ato të johebrenjve, që kishin vlera dhe praktika të ndryshme, tani u desh që të bashkekzistonin, por diferencat e tyre krijuan një konflikt kulturor.

Pali iu kujtoi atyre se uniteti i tyre në ungjillin duhej t’i tejkalonte diferencat e tyre (Romakëve 1:16; 10:12,13). Ai vërtetoi se johebrenjtë janë të humbur (Romakëve 1:18-27), por po kështu janë edhe hebrenjtë (Romakëve 2:12-29). Të gjithë njerëzit janë mëkatarë nën gjykimin e Perëndisë (Romakëve 2:9; 3:9). Por në rast se të gjithë jemi njësoj të humbur,

atëherë të gjithë duhet të shpëtohem vetëm mbi të njëjtat kushte, përmes besimit tek Krishti.

Hebrenjtë shpesh besonin se ata ishin të shpëtuar për shkak se ishin fëmijët e Abrahamit. Ata ishin pjesë e njerëzve të shpëtuar për shkak se kishin besëlidhjen e rrethprerjes. E megjithatë, Pali u kujtoi besimtarëve në Romë se rrethprerja frymërore dhe prejardhja frymërore nga Abrahami nuk janë ato që kanë vlerë për sa i takon shpëtimit (Romakëve 2:25-29; 4:9-12); ata duhet të besonin siç bëri Abrahami (Romakëve 4:11,12,16). Për më tepër, në rast se ndokush vazhdonte ende të apelonte ndaj prejardhjes prej Abrahamit për shpëtimin e tij, Pali u kujtoi se të gjithë janë pasardhës të Adamit (Romakëve 5:12-21). Hebrenjtë e shihnin pasjen e Ligjit si një shenjë superioriteti mbi johebrejtë, por Pali theksoi se edhe pse Ligji mund të mësonte të drejtën nga e gabuara, ai nuk kishte asnjë fuqi për ta bërë dikë të drejtë (Romakëve 7:7-12).

Populli hebre kishte privilegje të veçanta (Romakëve 9:4,5), por ato nuk e garantonin shpëtimin. As Ismaeli dhe as Esau nuk e morën premtimin; thjesht prejardhja gjenetike nga Abrahami nuk e garantonte pjesëmarrjen shpëtuese në besëlidhjen e Perëndisë (Romakëve 9:6-13). Hebrenjtë theksonin përzgjedhjen e tyre për shkak të Abrahamit; megjithatë, në lidhje me shpëtimin, Perëndia mund të zgjidhte pa marrë parasysh etninë (Romakëve 9:19-29), bazuar, nga ana tjetër, në besimin tek Krishti (Romakëve 9:30 - 10:15). Secili prej nesh duhet të shpëtohet në të njëjtën mënyrë. Prandaj, ungjilli që na pajton me Perëndinë gjithashtu na pajton edhe me njëri-tjetrin.

Megjithatë, problemi në Romë nuk ishte vetëm përbuzja e johebrejve nga besimtarët hebrenj. Pali i qorton të krishterët johebrej që të mos e përçmonin popullin hebre apo trashëgiminë e tyre (Romakëve 11:17-24). Johebrejtë në Romë i përbuznin hebrenjtë pjesërisht për shkak të zakoneve të tyre të çuditshme për sa i përket ushqimit dhe ditëve të shenjta, të cilat ndryshonin nga praktikatat romake. Pali theksoi se ne nuk duhet të shikojmë me përbuzje njëri-tjetrin për shkak të këtyre diferencave; ne mund të qëndrojmë të ndryshëm nga ana e kulturave, dhe prapë të jemi të bashkuar në Krishtin (Romakëve 14:1-23). Unitet nuk do të thotë njëtrajtshmëri, e cila shpesh përfshin asimilimin në atë kulturë që është më mbizotëruese. Përkundrazi, ne duhet të vlerësojmë dhuratat që sillen nga secila kulturë, të lidhura jo nga ndonjë mega-kulturë, por nga besimi dhe nga Fryma jonë e përbashkët.

Nga fundi i letrës, Pali përmend Jezusin (Romakëve 15:8,9) dhe veten e tij (Romakëve 15:16,25) si



modelet e shërbimit tek të gjithë njerëzit. Nxitja e tij e fundit tek Letra Drejtuar Romakëve përfshin paralajmërimin për të pasur kujdes nga ata që shkaktojnë përçarje (Romakëve 16:17). Në praktikë, kjo do të thotë se duhet të punojmë, jetojmë dhe të duam së bashku (krahasoni Galatasve 2:11-14). Tek Letra Drejtuar Romakëve, Pali u bën thirrje besimtarëve që të kapërcejnë një barrierë që vetë Perëndia e kishte vendosur në histori, barrierën midis hebrenjve dhe johebrejve. Në qoftë se është kështu, atëherë sa më shumë thirrje na bën ai neve që të kapërcejmë barrierat të vendosura thjesht nga mëkati dhe intoleranca njerëzore?

NJË TEMPULL I RI

Konflikti i Palit në tempullin e Jerusalemit filloi kur disa hebrenj nga Efesi e akuzuan gabimisht Palin se kishte sjellë një johebre efesian brenda tempullit të tyre të shenjtë (Veprat e Apostujve 21:28,29). Për shkak se edhe akuzuesit e Palit edhe shoqëruesi i tij johebre ishin nga Efesi, kisha në Efes duhet ta ketë mësuar se si përfundoi Pali nën ruajtjen e romakëve.

Kur Pali u shkroi efesianëve, kisha e dinte se ai ishte akuzuar që kishte çuar një johebre përtej murit ndarës dhe brenda një oborri të brendshëm të tempullit ku lejoheshin vetëm hebrenjtë. Ky mur ndarës nuk ekzistonte në Dhjatën e Vjetër, por u ndërtua në tempullin e Herodit për t'iu përshtatur kuptimit që kishin priftërinjtë rreth kërkesave për pastërti. Për Palin, dhe për audiencën e tij në Efes, nuk mund të kishte asnjë simbol më të madh të barrierës përçarëse midis hebrenjve dhe johebrejve sesa ky mur. Prandaj edhe mesazhi i Palit për ta

është kaq goditës. Në kontekstin kur flitet për një tempull të ri, Pali deklaroi se copa e murit ndarës është shkatërruar nga kryqi i Krishtit (Efesianëve 2:14,19-22).

Pali nuk ishte i pari që sfidoi këtë ndarje në tempull. Një gjeneratë më herët, Jezusi përmbysi tavolinat në tempull dhe bërtiti se tempulli kishte për qëllim të ishte një “shtëpi e lutjes për të gjithë kombet”, por mbikëqyrësit e tij aktualë e kishin “bërë [atë] shpellë kusarësh!” (Marku 11:17). Në këtë deklaratë Jezusi përzjeu dy pasazhe. Pasazhi i parë shpallte planin e Perëndisë për t’i mirëpritur johebrenjtë (Isaia 56:3-7); i dyti shpallte gjykim mbi ata të cilët mendonin se tempulli iu siguronte atyre një strehë nga gjykimi pa pendesë (Jeremia 7:4-14). Deri diku, Jezusi po lajmëronte një gjykim mbi një institucion fetar të ndarë. Dhe dyzet vite më vonë, tempulli tokësor shtrihej i rrënuar.

Kur një grua samaritane pranoi se Jezusi ishte një profet, ajo kuptoi se hebrenjtë duhet të kishin të drejtë kur vinte puna tek feja. Në fund të fundit, samaritanët nuk besonin se kishte profetë midis Moisiut dhe Mesias. Për fat të keq, ky pranim i

përfshiti ata, sepse samaritanët nuk ishin të mirëpritur në tempullin e Jerusalemit. Dhe kështu Jezusi i tregoi asaj për një tempull të ri, i cili nuk ishte as në Jerusalem (ku adhuronin hebrenjtë) dhe as në malin Gerizim (ku adhuronin samaritanët), por “në frymë dhe në të vërtetë” (Gjoni 4:20-24). Ky vendbanim i Frymës ishte tempulli i ri për të cilin Pali tha se mirëpriste si hebrenjtë, edhe johebrenjtë (Efesianëve 2:14-22).

PËRPARA KISHAVE TË JERUSALEMIT DHE TË ANTIOKISË

Megjithëse plani i Perëndisë për një popull shumë-kulturor dukej diçka e re për kishën e hershme, ai ishte pjesë e planit të Perëndisë që prej fillimit. Nga fillimi, Perëndia zgjodhi Abramin në mënyrë që përmes tij të bekoheshin të gjitha familjet e mbarë botës (Zanafilla 12:3; 18:18; 22:18).

Perëndia e kishte ndarë Izraelin e lashtë nga kombet për të mirën e vetë Izraelit, por ai kishte bërë gjithmonë përjashtime. Të krishterët e parë filluan shumë shpejt që t’i vinin re këto përjashtime. I akuzuar se kishte mohuar idenë se tempulli ishte

IDEALE TË PROPOZUARA për t’u bërë ndërkulturor

Të qenit ndërkulturor përkon me misionin e kishës për të arritur të gjitha grupet etnike me ungjillin (Mateu 28:18-20). Ndërgjegjësimi dhe dijenia se Perëndia ka vendosur persona nga kombe të tjera në afërsi të një kishe vendore, i jep shkas asaj kishe për një reagim misionar. “Dhe ai ka bërë nga një gjak i vetëm çdo komb njerëzish, që të banojnë në mbarë fagen e dheut, dhe paracaktoi kohërat me radhë dhe kufijtë e banimit të tyre, që të kërkojnë Zotin, mbase mund ta prekin edhe ta gjejnë, ndonëse ai nuk është larg nga secili prej nesh” (Veprat e Apostujve 17:26,27).

Të qenit ndërkulturor korrespondon me natyrën e ungjillit për të pajtuar botën në Krishtin Jezus (2 Korintasve 5:14-21; Galatasve 3:28). Pa njëanshmëri, kisha vendore i arrin ata që ka përreth, përmes rolit të shërbestarëve të pajtimit.

Të qenit ndërkulturor përputhet me natyrën e Kishës për të qenë një komunitet shpengues i cili

pasqyron njerëzimin e ri në Jezu Krishtin (Efesianëve 2:11-22). Kisha vendore, me persona nga etni dhe formime të ndryshme kulturore, ka privilegjin për të demonstruar se si vepra e Krishtit brenda tyre ka rrëzuar muret ndarëse të armiqësisë dhe urrejtjes.

Të qenit ndërkulturor përcjell një tablo të adhurimit shumëkulturor sepse çdo komb, fis, popull dhe gjuhë do të adhurojë së bashku përpara fronit të Perëndisë (Zbulesa 7:9-12). Kisha vendore ka mundësinë për të demonstruar aspekte të adhurimit të bashkuar të komunitetit të ardhshëm qiellor.



DAVID WELLS,
administrator i Asambleve
Pentekostale të Kanadasë për
distriktin e British Kolombia,
Jukon.

qendror, Stefani u kujtoi akuzuesve të tij se Perëndia i foli Abramit në Mesopotami, e lartësoi Jozefin në Egjipt dhe iu shfaq Moisiut në shkretëtirën e Midianit. Po të kishte dashur Stefani, ai mund të kishte apeluar tek Jona; tek shërbëtorët e Perëndisë në robëri, siç ishin Danieli dhe Esteri, apo madje edhe tek shumë të huaj që u mirëpritën në mbretërinë e Davidit (për shembull, 2 i Samuelit 6:10,11; 15:18–22; 1 i Mbretërve 1:44).

Edhe Mateu gjithashtu, i pranoi përjashtimet e Dhjatës së Vjetër. Megjithëse shumica e gjenealogjive të lashta i linin jashtë gratë, gjenealogjia që hap Ungjillin sipas Mateut përmend katër prej tyre. Këto nuk ishin, ndryshe nga ajo që do të prisnim neve, gratë më të famshme, si Sara apo Rebeka. Përkundrazi, ato ishin Tamara, nga Kanaani (Mateu 1:3); Rahabi, nga Jeriko (1:5); Ruthi, nga Moabi (1:5); dhe e veja e hiteut Uriah (1:6). Tre paraardhës të mbretit David dhe nëna e mbretit Salomon ishin johebrenj ose, në rastin e bashkëshortes të Urias, kishin lidhje me johebrenjtë.

Besimi tek diversiteti me fjalë mund të jetë një hap përpara, por besimi i jetuar në praktikë kërkon më shumë përpjekje.

Shembujt e Mateut janë të matur. Tek Jozueu (në kundërshtim me ata që mendojnë se libri i kundërshton të gjithë johebrenjtë), Rahabi është në kontrast me izraelitin Akan. Duke i fshehur spiunët në çatinë e saj, Rahabi tradhtoi popullin e saj dhe shpëtoi familjen e vet; duke fshehur plaçkën e luftës nën dysHEME, Akani tradhtoi popullin e tij dhe shkatërroi familjen e vet. Po ashtu, libri i Ruthit fokusohet tek një moabite që bëhet pjesë e qëllimit të Perëndisë për një periudhë të gjatë në histori.

Kjo gjenealogji është një mënyrë e jashtëzakonshme për Mateun që të fillojë Ungjillin e tij dhe të dërgojë një mesazh të fortë tek bashkëkombësit e tij të krishterë. Gjenealogjitë e lashta judease zakonisht theksonin pastërtinë e prejardhjes izraelite të dikujt; Mateu nxori qëllimisht në pah natyrën ndër-racore të paraardhjes ligjore të Jezusit përmes prejardhjes së Davidit. (Bibla gjithashtu përmend bashkime të tjera ndëretnike, me qëllime hyjnore, siç ishin bashkimi mes Jozefit dhe Asenathit (Zanafilla 41:45); Moisiut dhe Seforës (Eksodi 2:21); apo mes Esterit dhe Asueros (Esteri 2:16)).

Ky theksim për mirëpritjen e johebrenjve vazhdoi edhe gjatë jetës tokësore të Jezusit. Megjithëse dijetarët ishin armiqtë e Danielit, Mateu raporton për disa dijetarë persianë të cilët erdhën që të adhuronin mbretin e hebrenjve. Krahësimisht, Herodi, mbreti jude, u soll si faraoni johebre i kohëve të lashta duke vlarë fëmijët meshkuj (Mateu 2:1-18). Brutaliteti i Herodit detyroi familjarët e Jezusit që të iknin si refugjatë në Afrikë, në Egjipt, njësoj si Moisiu që dikur u arratis për në Midian për t'i shpëtuar faraonit (Mateu 2:13-15).

Ungjilli sipas Mateut ofron të dhëna të tjera rreth përkushtimit që Perëndia kishte për të gjithë popujt. Jezusi u vendos në një zonë që dikur identifikohet me johebrenjtë (Mateu 4:15). Ai shëroi shërbëtorin e një kryeqindësi (Mateu 8:5-13), dhe gjithashtu lajmëroi se Perëndia do të përfshinte tek populli i Tij shumë vetë nga lindja, siç ishin dijetarët, dhe nga perëndimi, siç ishte një romak që besoi (Mateu 8:11). Jezusi çliroi njerëz të pushtuar nga demonët në territor johebre (Mateu 8:28-34; vini re derrat tek vargu 30), dhe e nxori nga Pjetri rrëfimin e besimit në një zonë famëkeqe pagane (Mateu 16:13-20). Më vonë, pjesëtarë nga skuadra e ekzekutimit, persona të cilët ishin johebrenj, ishin të parët që pranuan identitetin e Jezusit në kryq (Mateu 27:54). Ungjilli sipas Mateut e arrin pikën kulmore me porosinë e Jezusit për të bërë dishepuj të gjitha kombet (Mateu 28:19,20), duke qenë pjesë e përmbyshjes së premtimit se të gjitha kombet do të dëgjonin (Mateu 24:14).

Duke qartësuar zemrën e Perëndisë që tashmë ishte e pranishme në Dhjatën e Vjetër, Jezusi përgatiti rrugën për misionin e johebrenjve tek Veprat e Apostujve, e cila, nga ana tjetër, orienton drejt qëllimit të kishës së larmishme të Krishtit nga të gjithë popujt.

TA JETOJMË PËRKUSHTIMIN NË PRAKTIKË

Besimi tek diversiteti me fjalë mund të jetë një hap përpara, por besimi i jetuar në praktikë kërkon më shumë përpjekje. Si të krishterë, ne duhet t'i vendosim burimet tona aty ku janë fjalët tona, dhe të kuptojmë se aty ku janë burimet tona, pikërisht aty është gjithashtu edhe zemra jonë. Pas ditës së Rrëshajave, Kisha e hershme mësoi të ndante burimet e saj jo vetëm me fqinjët e tyre derë për derë (Veprat e Apostujve 2:44,45), por gjithashtu edhe me nevojtarët në pjesë të tjera të botës (Veprat e Apostujve 11:28-30). Një pjesë e qëllimit të udhëtimit të fundit që Pali bëri në Jerusalem ishte sjellja e ofrimeve për të varfrit nga kishat e johebrenjve (1

Korintasve 16:1–4; 2 Korintasve 8:1–9:15), si një simbol i unitetit mes kishave të hebrenjve dhe johebrenjve (Romakëve 15:26,27). Ndërkohë që kishat duhet të mbështesin veten e tyre, zija e bukës dhe arsimimi teologjik janë çështje të ndryshme. Ka disa rajone sot ku burimet tona mund t'i shërbejnë me më shumë efikasitet mbretërisë së Perëndisë. Një partneritet i tillë gjithashtu mund të nënvizojë unitetin e kishës së Krishtit, ku secila pjesë e kishës ndan dhuntitë që Perëndia i ka dhënë për përfitimin e të tjerëve.

Megjithatë, shqetësimi ndërkulturor nuk ka të bëjë vetëm me paratë, por se ku janë zemrat tona. Të krishterët në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u tmerruan me të drejtë kur xhihadistët vranë 3 mijë njerëz në 11 shtator 2001. Por xhihadistët kanë filluar disa ditë mëparë të vrasin të krishterë në veriun e Nigerisë, me një numër vdekjesh padyshim shumë herë më të lartë. Po ashtu, sipas disa për-llogaritjeve, dhjetëfishi i atij numri njerëzish, shumica prej tyre fëmijë, vdesin **çdo ditë** nga keq-ushqyerja ose nga sëmundje të parandalueshme.

Shumë prej atyre që vdesin ose që qajnë fëmijët e tyre të vrarë janë vëllezërit dhe motrat tona. Edhe pse kemi të drejtë që kujdesemi për atdheun tonë, a prekemi më shumë nga gjërat që u ndodhin bashkëqytetarëve tanë nga e njëjta kulturë apo nga gjërat që u ndodhin bashkëqytetarëve tanë të Mbretërisë, pavarësisht nga kombësia, raca apo etnia? Me cilën mbretëri identifikohemi fillimisht? A jemi më shumë si kisha në Jerusalem apo si kisha në Antioki?

Dhe as nuk zbatohet ky parim vetëm tek ata që janë larg. Në rast se disa të krishterë minoritarë për-ballen me diskriminim në punë ose me vështirësinë për t'iu përshtatur me një kulturë të re, a jemi ne të gatshëm që t'i dëgjojmë dhe të bëhemi partnerë me ta për të gjetur zgjidhje? Uniteti etnik dhe racor duhet t'i tejkalojë idealet e larta; kjo kërkon që të ndjekim shembullin sakrifikues të Jezusit për të dashur ashtu siç na deshi edhe Ai neve (Gjoni 13:14,15,34,35). E megjithatë, bashkë me sakrificën vjen bekimi, sepse në pjesë të tjera të trupit të Krishtit, Ai ka vendosur

dhunti dhe burime të cilat ata mund t'i ndajnë me ne (për shembull: se si të vuajmë me gëzim; si të restaurojmë zemërthyerin; ose si të japim me sakrificë).

Asgjë nuk do t'i zbusë zemrat tona karshi vëllezërve dhe motrave tanë nga kulturat e tjera më tepër sesa kur të mësojmë t'i njohim ata dhe të rizbulojmë unitetin tonë të përbashkët në Krishtin. Negocimi i ndryshimeve, sidomos në një largësi të afërt në të njëjtën bashkësi, është më sfidues. E megjithatë, në qoftë se ne i besojmë ungjillit, atëherë besojmë se mund të gjejmë hir për t'i kapërcyer ato vështirësi.

Leximi i një artikulli mund të na e trazojë interesin, por vënia në praktikë e shërbesës ndërkulturore, bashkë me të gjitha sakrificat, keqkuptimet dhe bekimet që e shoqërojnë përgjatë rrugës, na çojnë në vende më të thella. Kur të fillojmë që të dëgjojmë dhe të mësojmë nga besimtarë nga kultura, etni dhe raca të tjera, atëherë do të fillojmë të jetojmë në unitet ndërkulturor.

PËRMBYLLJE

E hapëm këtë vështrim të përgjithshëm të themeleve biblike për larminë racore dhe etnike duke iu referuar vegimit të Gjonit rreth unitetit shumëkulturor në qiell. Morris Uilliams, një ish misionar afrikan, kur jepte mësim në Seminarin Teologjik të Asambleve të Perëndisë, do t'i drejtohej këtij vegimi të qiellit për të theksuar se Perëndia krijoi kultura të ndryshme për një qëllim të qëndrueshëm. Në qëllimin e Perëndisë, ishte e rëndësishme që këto kultura të qëndronin si një dëshmi për krijimin e Tij të lavdishëm përgjatë gjithë epokës së përjetësisë, por që përsëri të vijnë bashkë në unitet për t'i shërbyer Perëndisë së vetëm të gjallë.

Babeli ka marrë kuptim të kundërt. Me dhuntinë e gjuhëve të panjohura, mes bekimeve të tjera, Perëndia na ka dhënë gjuhët e shumë kombeve si një shenjë e qëllimit të tij: një kishë e bashkuar nga çdo lidhje gjaku, fisi, populli dhe kombi. Kjo është thirrja jonë; kjo është pika jonë e mbërritjes. U bëftë vullneti i tij tani në tokë si në qiell. Amen.



CRAIG S. KEENER, Ph.D. është profesor i Dhiatës së Re në Seminarin Teologjik të Asburit dhe një i diplomuar i Seminarit Teologjik të Asambleve të Perëndisë. Ai është autor i 15 librave, duke përfshirë *IVP Bible Background Commentary: New Testament* (me gjysmë milioni kopje të shitura), si dhe këto vepra shumë-vëllimshme në vijim me shtëpinë botuese Baker Academic: *The Gospel of John: A Commentary*; *Miracles: The Credibility of the New Testament Accounts*; dhe *Acts: An Exegetical Commentary*.

në

Ndjehem
kaq e
vetmuar.

A ka ndonjë
qëllim jeta
ime?

A do e ndjejë
kush mungesën
kur të kem ikur?

A MUNDEM
UNË QË T'I
NDIHMOK ATA?

A nuk është një
mashtim në të
vërtetë?

Jam
kaq e
trishtuar.

A nuk ka më
tjetër gjë atje
jashtë?

SI DO TË DËGJOJNË?

Sfida e Mosungjillizimit

Nga: RANDY HURST

Kompania ajrore më kishte humbur valixhen në një fluturim për në Londër. Ndërsa po merrja fluturimin për t'u kthyer në Amerikë, kur isha tek kontrolli i biletave, menaxheri vendor i kompanisë më kërkoi falje për valixhen dhe më ofroi një vend në klasin e parë.

Stjuardesa që po më shërbente ishte e sjellshme. Nga biseda jonë, ajo mësoi se unë punoja në kishë. Gjatë bashkëbisedimit tonë, Fryma e Shenjtë nguliti një mendim në zemrën time në lidhje me një çështje specifike në jetën e saj. Më në fund, unë i thashë: “Kam diçka për t’ju thënë. Nuk kam fluturuar kurrë në klasin e parë nga Londra për në Dallas. Por, besoj se këtë e ka planifikuar Perëndia; jo që unë të kem një udhëtim të këndshëm për në shtëpi, por, Ai më ka vendosur këtu për ju. Ju sapo jeni divorcuar, apo jo?”.

Ndërkohë që ajo pohoi me kokë, unë vijova më tej: “Perëndia kishte një plan për jetën tuaj që përpara se të lindnit, por ky plan nuk po ndodh. Dhe nuk mund të ndodhë derisa ju të pranoni faljen e Tij dhe ta dorëzoni jetën tuaj tek Krishti”. Pastaj e pyeta: “A mund të lutem bashkë me ju që të pranoni Jezu Krishtin si shpëtimtarin tuaj?”.

“Po”, u përgjigj ajo, “sepse edhe unë kam diçka për t’ju thënë. As unë nuk kam fluturuar kurrë në klasin e parë nga Londra për në Dallas. Një stjuardesë tjetër nuk kishte ardhur sepse ishte sëmurë. Para se të dilja nga apartamenti im, bëra diçka që nuk e kisha bërë për shumë vite; u luta, dhe thashë: „O Perëndi, ti e di që jeta ime është lëmsh. Duhet të më tregosh gjatë këtij udhëtimi se çfarë duhet të bëj”. Pasi u luta me të që ajo të pranonte Krishtin, fytyra e saj shndriste nga gëzimi.

Disa vite më vonë mora një telefonatë nga një grua, e cila tha: “Ju nuk më njihni. Numrin tuaj ma ka dhënë pastori im. Unë jam një stjuardesë. Këtë javë takova një stjuardesë tjetër dhe zbuluam se të dyja ishim të krishtera. Kur filluam të ndanim dëshmitë tona, ajo më tregoi se e kishte pranuar Jezusin në një fluturim nga Londra

në Dallas, dhe përmendi emrin tuaj. Unë i tregova që ju kishit predikuar në kishën time. Ajo më kërkoi t’ju kontaktoja dhe t’ju tregoja se ajo ende po i shërbën Jezusit me besnikëri dhe po me besnikëri vazhdon që të shkojë në kishë”.

Në çdo rast tregimi dëshmie që kam përjetuar, në të cilin një jobesimtar pranon Krishtin, kam zbuluar se Perëndia e kishte përgatitur tashmë zemrën e atij personi për mesazhin.

Bibla na mëson në mënyrë të qartë se ndarja personale e dëshmisë sonë nuk është vetëm për ata pak persona që janë veçanërisht të talentuar për të qenë ungjilltarë (Efesianëve 4:11). Kjo është përgjegjësia e secilit ndjekës të Krishtit. Filipi është personi i vetëm në Dhjatën e Re i cili është quajtur ungjilltar. Tek Veprat e Apostujve 8, Perëndia e përdori Filipin për të sjellë në besim eunukun etiopas, duke siguruar kështu një shembull të asaj që bën një ungjilltar. Në kulturën moderne, shumica e njerëzve mendojnë se ungjilltarët janë ata që iu predikojnë turmave të mëdha nëpër stadione ose përmes televizionit. Por shembulli i Filipit është një takim ungjillëzues personal veç e veç.

Është e arsyeshme që njerëzit të kenë si objektiv që të ndajnë besimin e tyre me një numër njerëzish në vit. Por, në qoftë se është e arsyeshme, përse nuk e bëjnë këtë me shumë të krishterë?

Çfarë mund të ndodhë në qoftë se shumica e besimtarëve do të mësonte nga Fjala e Perëndisë se përgjegjësia e tyre nuk është që të bindin jobesimtarët për t'u bërë të krishterë, por "të mbjellin" dhe "të ujin" mesazhin e Jezusit, kudo ku Perëndia i hap dyert për këtë mundësi?

Është e arsyeshme që njerëzit të kenë si objektiv të ndajnë besimin e tyre me një numër njerëzish në vit. Por, në qoftë se kjo gjë është e arsyeshme, përse nuk e bëjnë këtë më shumë të krishterë? Ky artikull shpjegon se pse njerëzit e neglizhojnë ungjillëzimin personal, ai skicon një teologji biblike të ungjillëzimit, si dhe ofron dy praktikatat më të mira të bazuara në atë teologji, të cilat mund të jenë ndihmë për të angazhuar më shumë besimtarë në ungjillëzimin personal.

PËRSE NUK JAPIN DËSHMI NJERËZIT

Në kohën kur studioja në seminarin teologjik, një profesor ndau rezultatet e një studimi të gjerë të kishave ungjillore. Studimi tregonte se pothuajse i gjithë ungjillëzimi personal bëhet nga më pak se 10 përqind e cilësdo bashkësie të përzgjedhur.

Përse, në shumicën dërrmuese, besimtarët nuk e ndajnë besimin e tyre me jobesimtarët? Në vijim po paraqes katër arsye të rëndësishme.

Apatia apo plogështia

Studimi, të cilit iu referua profesori, gjithashtu tregonte se nga 10 përqindëshi në bashkësinë e atyre që e ndajnë besimin e tyre, pjesa dërrmuese e tyre kanë qenë të krishterë për më pak se një vit. Shumë prej atyre që kanë qenë të krishterë për shumë vjet kanë një tendencë që ta humbasin zellin e tyre për ndarjen e ungjillit. Drejtuesit e kishës duhet ta adresojnë problemin e apatisë frymërore dhe të vazhdojnë t'i motivojnë njerëzit e tyre për të arritur të humburit.

Mungesa e vetëbesimit

Ndërkohë që shumë njerëz mendojnë se arsyeja më e zakonshme që njerëzit nuk e ndajnë ungjillin është apatia, unë besoj se për shumicën e njerëzve problemi më i madh është mungesa e vetëbesimit. Shumica e ndjekësve të Krishtit duan të jenë dëshmitarë të efektshëm. Por shumë besimtarë ndi-

hen të papërshtatshëm, të kërcënuar apo madje të frikësuar për ta ndarë besimin që ata kanë tek Krishti, veçanërisht me dikë i cili nuk ka një sfond fetar të krishterë.

Pluralizmi dhe një klimë tolerance

Në kulturën popullore, toleranca fetare konsiderohet si një virtyt. Disa fe kryesore, siç janë Budizmi apo Hinduizmi, janë pluraliste për nga natyra. Botë-kuptimi, që sa vjen dhe bëhet më i përhapur dhe popullor, është se asnjë fe nuk është burimi i vetëm apo ekskluziv i së vërtetës (nëse ekziston edhe e vërteta), dhe që, njëfarë vlere dhe e vërtete ekziston në çdo fe. Shumë të krishterë tani besojnë se ungjillëzimi i drejtpërdrejtë është mosrespektues ndaj besimeve të të tjerëve.

Besimet e gabuara

Shumë njerëz nuk e kuptojnë domosdoshmërinë e ungjillëzimit për shkak të supozimeve të rreme që kanë rreth gjendjes frymërore të njeriut dhe mënyrës së shpëtimit. Kultura laike përpiqet ta shpjegojë mëkatën e njeriut duke e minimizuar atë. Ata ia atribuojnë imoralitetin dhe dhunën varfërisë, padrejtësisë shoqërore dhe madje edhe formimit gjenetik.

Mendimi mbizotërues, përfshirë këtu edhe i një numri gjithnjë në rritje të krishterësh ungjillorë, pranon se Perëndia do ta gjykojë njerëzimin e pashpenguar dhe pastaj, ashtu si kafshët, do t'i shfarosë ata. Madje që prej kohës së Kishës së hershme shumë njerëz kanë speculuar, me dëshirën e mirë, që të gjithë njerëzit do të arrinin, eventualisht, në një mënyrë, parajsën. Një pjesë e mirë e kulturës bashkëkohore e promovon idenë se çdo gjë që beson dikush mund të jetë një rrugë drejt jetës së përjetshme dhe paqes përfundimtare.

Në rast se i adresojmë besimet e gabuara me të vërteta biblike, do të zgjidhim në një masë të madhe problemet e indiferentizmit, mungesës së vetëbesimit dhe çështjeve të pluralizmit dhe tolerancës.

TË VËRTETA BIBLIKE NË LIDHJE ME UNGJILLËZIMIN

Gjendja frymërore e njeriut dhe rruga e shpëtimit

Tri fakte janë të pashmangshme: fakti që njerëzimi është i humbur, siguria e përjetësisë dhe ekskluziviteti i Jezu Krishtit.

Njerëzimi është i humbur

Fjala e Perëndisë e tregon qartë se i gjithë njerëzimi është i humbur, duke qenë se “të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë” (Romakëve 3:23¹).

Në njërën prej qyteteve moderne të Azisë, në mesin e rrokaqiejve shkëlqim-plota, vizitova një tempull pagan. Kishte me mijëra spektatorë që qëndronin në oborrin e jashtëm. Në mënyrë të pavullnetshme, i shtyrë nga turma që lëvizte, u gjenda vetëm disa metra larg një prifti i cili po këndonte pa pushim, ndërkohë që adhuruesit iu nënshtruan një ekstaze demonike. Një sërë kanxhash prej çeliku shponin mishin e kurrizit të tyre, e megjithatë nuk u dilte asnjë pikë gjak. Secila nga kanxhat ishte e lidhur me një zinxhir i cili shtrihej deri në pjesën e pasme të një qerreje me gurë. Adhuruesit e tërhiqnin qerren nëpër rrugë në një përpjekje për të fituar falje, shërim ose prosperitet. Secila zgjedhë torturuese jepte dëshmi të heshtur e grafike të antitezës ndaj hirit të Perëndisë. Pavarësisht se sa trazuese janë këto imazhe, është e rëndësishme të mbajmë mend se edhe ata që pretendojnë se janë të krishterë, por nuk e njohin Krishtin personalisht, janë po aq të humbur sa kushdo që përputhet me stereotipin që përmbledh fjala “paganë”.

Përjetësia është e sigurt

Ndërkohë që të gjitha qeniet e krijuara e kanë një fillim, Fjala e Perëndisë tregon se kur fillon jeta njerëzore, ekzistenca nuk mbaron kurrë. Jezusi na dha mësim me këto fjalë: “Atëherë do t’u thotë edhe atyre që do të jenë në të majtë: “Largohuni nga unë, të mallkuar, në zjarr të përjetshëm”. ... Dhe ata do të

shkojnë në mundim të përjetshëm, dhe të drejtët në jetën e përjetshme” (Mat. 25:41,46). Çdo person do të përballet me një gjykim të fundit të përhershëm. Cilido qoftë fati i një personi, ky fat është i përjetshëm.

Jezu Krishti është rruga e vetme e shpëtimit

Bibla na mëson se ekziston vetëm një rrugë për të bërë paqe me Perëndinë dhe për të hyrë në jetën e përjetshme. Jezusi tha: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje” (Gjoni 14:6). Ai është edhe dera, edhe rruga. Pjetri tha: “Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell, që u është dhënë njerëzve, me anë të të cilit duhet të shpëtohem” (Veprat e Apostujve 4:12).

Natyra e ungjillëzimit

Fuqia e ungjillit

Apostulli Pal shkroi: “Unë u jam debitor grekëve dhe barbarëve, të urtëve dhe të paditurve. Kështu, aq sa varet nga unë, jam gati t’ju predikoj ungjillin edhe juve që jeni në Romë. Sepse, unë nuk kam turp për ungjillin e Krishtit, sepse *ai është fuqia e Perëndisë* për shpëtimin e cilitdo që beson, më parë judeun e pastaj grekun” (Romakëve 1:14-16, theksimi i pjerrët është bërë nga autori). Fuqia parësore tek ungjillëzimi nuk është tek korrieri, por tek *mesazhi*.

Pasi e ka treguar se fuqia për shpëtimin është ungjilli, Pali paraqet një argument imponues për urgjencën që ka shpallja e tij: “Sepse kushdo, që do ta thërrasë emrin e Zotit, do të shpëtohet. Si do ta thërrasin, pra, atë, të cilit nuk i besuan? Dhe si do të besojnë tek ai për të cilin nuk kanë dëgjuar? Dhe si do të dëgjojnë, pa predikues? Dhe si do të predikojnë pa qenë dërguar?” (Rom. 10:13-15). Pali, pasi lajmëroi ofertën e hirshme të Perëndisë në Krishtin, bën pyetje provokative dhe retorike sipas një rendi logjik, ku secila pyetje shtesë ndërtohet mbi foljen kyçe të pyetjes pararendëse. Përfundimi është i qartë: Ungjilli duhet të shpallet.

Nuk ekziston tragjedi më e madhe sesa kur njerëzit e humbur nga ana frymërore nuk arrijnë të dëgjojnë ungjillin për shkak se ndjekësit e Krishtit kanë neglizhuar që ta ndajnë mesazhin.

Kur Pali dha mësim në lidhje me shpalljen që ai i bënte ungjillit, ai zbuloi qartësisht se mesazhi ynë nuk është vetëm fjalë. Ai përfshin edhe vepra.

Ja çfarë u shkroi Pali besimtarëve në Selanik: “Sepse *ungjilli ynë* nuk erdhi deri te ju vetëm me fjalë, por edhe me fuqi dhe me Frymën e Shenjtë, dhe me shumë siguri; siç e dini si jemi sjellë në mes tuaj për shkakun tuaj” (1 Thesalonikasve 1:5, theksimi i pjerrët është bërë nga autori).

Dëshmia e Palit nuk ishte thjesht *ajo që ai tha* (“me fjalë”), por gjithashtu *mënyra* se si e tha (“me fuqi dhe me Frymën e Shenjtë, dhe me shumë siguri”), si dhe *kush ishte* (e dini si jemi sjellë në mes tuaj për shkakun tuaj”).

Ajo që themi.

Ungjilli është një mesazh të cilin duhet ta përcjellim me fjalë. Studimi i ungjillëzimit në Dhjatën e Re tregon në mënyrë përfundimtare se fokusi i mesazhit tonë duhet të jetë *Jezusi*. Në Kishën e hershme, mesazhi i besimtarëve fokusohet gjithmonë tek personi i Jezu Krishtit. Ndërkohë që të krishterët e parë e shpallnin Jezusin me guxim dhe me qartësi, shumë njerëz besuan.

Mënyra si e themi.

Emocionet, qëndrimet dhe veprimet tona janë po aq pjesë e mesazhit tonë sa edhe fjalët që themi. Në letrën që Pali iu drejttoi Kolosianëve, ai tha: “Ecni me urtësi ndaj të jashtëmëve duke shfrytëzuar kohën. Fjala juaj *të jetë gjithnjë me hir*, e ndrequr me kripë, që të dini si duhet t’i përgjigjeni gjithsecilit” (Kol. 4:5,6, theksimi i pjerrët është bërë nga autori). Apostulli Pjetër shkroi: “Jini gjithnjë gati për mbrojtje ndaj kujtdo që ju kërkon fjalë për shpresën që është në ju, por *me butësi e me druajtje*, duke pasur ndërgjegje të mirë, që, në atë, që ju përflasin si keqbërës, të turpërohen ata që fyejnë sjelljen tuaj të mirë në Krishtin” (1 Pjetrit 3:15,16, theksimi i pjerrët është bërë nga autori).

Si Pali, ashtu edhe Pjetri theksuan një dëshmi që përfshin më shumë sesa fjalë. Pali thotë që fjala jonë “të jetë gjithnjë me hir”. Pjetri thotë se duhet të flasim “me butësi e me druajtje”.

Kush jemi.

Në qoftë se mënyra jonë e të sjellurit dhe veprimet tona nuk janë në pajtim me fjalët tona, atëherë ato do

**Në çdo rast
tregimi dëshmie
që kam përjetuar,
në të cilin një
jobesimtar pranon
Krishtin, kam
zbuluar se
Perëndia e kishte
përgatitur tashmë
zemrën e atij
personi për
mesazhin.**

të jenë një pengesë e madhe për përmbajtjen e mesazhit tonë. Për shumë njerëz, veçanërisht për ata që njohim personalisht, dëshmia jonë vetjake e ndryshimit që Krishti ka bërë në jetët tona, si dhe prova e saj e qëndrueshme përmes veprave tona, do të jenë ato që kanë për t’i imponuar ata më së shumti.

Në një shoqëri ku njerëzit po e humbasin me shpejtësi besimin tek integriteti i udhëheqësve në qeveri apo në botën e biznesit, besueshmëria vetjake e të krishterëve nuk është thjesht një bekim i shtuar në dëshminë e dhënë, por është një kusht thelbësor.

Fuqizimi i Frymës

Pali u tha thesalonikasve se shpallja efikase e ungjillit ndodhte “me fuqi dhe me Frymën e Shenjtë”.

Fjala që përkthehet “fuqi” tek Veprat e Apostujve 1:8 (*dunamis*) është jashtëzakonisht gjithëpërfshirëse. Ajo thjesht do të thotë “aftësi” dhe përdoret për çdo nevojë që kemi në ungjillëzimin personal.

Fryma e Shenjtë na aftëson në të tre përbërësit e mesazhit tonë: në atë që themi, mënyrën si e themi dhe se kush jemi. Fryma e Shenjtë e fuqizon dëshminë tonë në atë që themi dhe se si e themi, pra, me një pasion të singertë e imponues. Ai gjithashtu na aftëson të *bëhemi* njerëzit që Perëndia na ka thirrur të jemi. Ndërkohë që e lejojmë frytin e Frymës, pra, natyrën e Jezu Krishtit, t’u japë formë jetëve tona, Krishti bëhet më i dukshëm tek ata që kemi përreth.

Kur ne i kuptojmë pasojat e përjetshme të faktit se jemi të humbur nga ana frymërore dhe të ekskluzivitetit të Krishtit, atëherë përballemi me apatinë dhe indiferencën tonë dhe adresojmë çështjet e pluralizmit dhe të tolerancës. Një kuptim i mirë i fuqisë së ungjillit dhe i natyrës së fuqizimit të lajmëtarit nga Fryma, e ndihmon vetëbesimin e besimtarëve në dëshminë e tyre personal.

PRAKTIKAT MË TË MIRA NË UNGJILLËZIMIN PERSONAL

Ne mund të studiojmë një gamë të gjerë praktikash të atyre që janë aktivë dhe të efektshëm në ungjillëzimin personal. Por cilat janë praktikat më të mira për të angazhuar ata njerëz që nuk janë aktivë? Janë dy praktika që janë të dukshme nga mësimi i apostujve Pal dhe Pjetër, të cilat janë më të frytshmet për t’i ndihmuar besimtarët që të fillojnë të angazhohen në ungjillëzimin personal.

Të hyjmë brenda punës së Perëndisë në ungjillëzim

Pali, në letrën e tij të parë drejtuar Korintasve, e përshkruan ndarjen e ungjillit nga pikëpamja e mbjelljes dhe ujitjes së farave: “Unë mbolla, Apoli

ujiti, por Perëndia i bëri të rriten” (1 Korintasve 3:6). Në këtë deklaratë, Pali bën dallimin e qartë mes punës së Perëndisë në të korrat frymërore nga puna e shërbëtorëve të Tij njerëzorë. Kohët e foljeve që Pali përdor këtu janë të ndryshme. Kur Pali dhe Apoli mbollën dhe ujitën farën (mesazhin), koha e foljeve në greqisht tregon se për një periudhë kohore mbolli Pali, pastaj për një periudhë tjetër kohore e ujiti Apoli. Por kur Pali përshkruan aktivitetin e Perëndisë në këtë proces, folja e përdorur tregon qartë se Perëndia jo vetëm që punoi pasi fara ishte mbjellë dhe ujitur, por *gjatë gjithë kohës*. “*Perëndia i bëri të rriten*” (theksimi i pjerrët është bërë nga autori).

Njerëzit në kishat tona duhet të kuptojnë ndryshimin midis pjesës që ka Perëndia në ungjillëzim dhe pjesës sonë. Në disa aspekte, ungjillëzimi është një proces bindës. Tek Letra e Dytë Drejtuar Korintasve, Pali shkruan: “Duke e ditur, pra, frikën e Zotit, ne bindim njerëzit” (2 Korintasve 5:11). Por ungjillëzimi është ndryshe nga bindja normale njerëzore. Pali gjithashtu shkroi: “Dhe fjala ime dhe predikimi im *nuk u bënë me fjalë mbushamendëse* nga urtësia njerëzore, por në dëftim të Frymës dhe të fuqisë” (1 Korintasve 2:4, theksimi i pjerrët është bërë nga autori). Megjithëse Pali, pa asnjë dyshim, kishte aftësi bindëse, ai e kuptoi se urtësia tokësore dhe mbushamendja njerëzore nuk ishin të përshtatshme për t’i arritur njerëzit me ungjillin.

Shumica e ndjekësve të Krishtit duan me të vërtetë të jenë dëshmitarë të efektshëm. Por shumë ndjekës ndihen të papërshtatshëm, të kërcënuar ose madje të frikësuar për ta ndarë besimin e tyre në Krishtin. Një arsye domethënëse për këtë është ideja e gabuar se ne si besimtarë jemi përgjegjës për t’u mbushur mendjen jobesimtarëve për t’u bërë të krishterë. Megjithëse ne kemi përgjegjësi për të bërë pjesën tonë, pra, të ndajmë ungjillin, vetëm Perëndia mund ta hapë zemrën e një personi për të vendosur (Veprat e Apostujve 16:14).

Edhe pse Perëndia ka zgjedhur të na përfshijë në procesin e ungjillëzimit, pjesa jonë është e mundur vetëm për shkak se Fryma e Shenjtë po punon tashmë tek njerëzit, madje që përpara se ne ta ndajmë mesazhin. Dëshmimi nuk është thjesht një detyrë e mbushamendjes njerëzore. Ungjillëzimi është puna e Perëndisë, një punë ku ne jemi të privilegjuar të bashkëpunojmë me Frymën e Shenjtë për të arritur të humburit frymërorë.

Ungjillëzimi reagues

Dëshmimi nuk është thjesht një komunikim i njëanshëm. Përsëri, Pali tha: “Fjala juaj të jetë gjithnjë me hir, e ndrequr me kripë, që të dini si duhet t’i përgjigjeni gjithsecilit” (Kolosianëve 4:6); ndërsa Pjetri tha: “Jini gjithnjë gati për mbrojtje ndaj kujtdo që ju kërkon

fjalë për shpresën që është në ju” (1 Pjetrit 3:15).

Si Pali, edhe Pjetri, apostuj të cilët patën shumë ndikim në përhapjen e Krishterimit dhe njiheshin për predikimin e tyre të fuqishëm, dhanë mësim se komunikimi me jobesimtarët përfshinte reagim nga ana jonë, dhe jo vetëm shpallje. Ungjillëzimi reagues e pranon sovranitetin e Perëndisë dhe varet nga aktiviteti i Tij. Kjo gjë na lejon neve që të përmbushim rolin tonë në procesin e ungjillëzimit, duke iu përgjigjur njerëzve ndërkohë që varemi tek ndihma e Frymës së Shenjtë.

Në çdo rast tregimi dëshmie që kam përjetuar në të cilin një jobesimtar pranon Krishtin, kam zbuluar se Perëndia e kishte përgatitur tashmë zemrën e atij personi për mesazhin. Kur ne e kuptojmë punën e Perëndisë në ungjillëzim, kjo gjë na bën të jemi të guximshëm, duke u mbështetur në punën e Tij bindëse. Gjithashtu mund të jemi të duruar, duke i besuar më mirë kohës së Tij sesa të përpiqemi t’i shtyjmë njerëzit drejt një vendimi të nxituar. Kjo na çliron nga ankthi dhe na jep lirinë për të mos qenë as hezitues e as të nxituar ndërkohë që kemi raporte me njerëzit. Në një bisedë reaguese me një jobesimtar, ne nuk mund të ndajmë gjithmonë atë që ne mund ta konsiderojmë si një prezantim të plotë të ungjillit. Por shumë pak njerëz marrin një vendim për Krishtin për shkak të një takimi të vetëm. Ne jemi “duke mbjellë” dhe “duke ujitur” mesazhin. Perëndia është duke i rritur. Fryma e Shenjtë i çon njerëzit të marrin një vendim.

PËRMBYLLJA

Çfarë mund të ndodhë në qoftë se shumica e besimtarëve do të mësonte nga Fjala e Perëndisë se përgjegjësia e tyre nuk është që të bindin jobesimtarët për t’u bërë të krishterë, por “të mbjellin” dhe “të ujin” mesazhin e Jezusit, kudo ku Perëndia i hap dyert për këtë mundësi?

Poeti dhe aktivisti amerikan kundër skllavërisë, John Greenleaf Whittier ka shkruar: “Nga të gjitha fjalët e trishtueshme të gjuhës apo të penës, ato më të trishtueshmet janë këto: „Mund të kishte ndodhur!” Nuk ekziston tragjedi më e madhe sesa kur njerëzit e humbur nga ana frymërore nuk arrijnë të dëgjojnë ungjillin për shkak se ndjekësit e Krishtit kanë neglizhuar që ta ndajnë mesazhin.



RANDY HURST, Drejtor i Sektorit të Përparimit, Asambleja e Perëndisë “Misioni për Botën”, Springfield, Misuri.



Takimi i Parë TË ASAMBLEVE



Është për çdo njeri është që të vendosë të bëjë diçka për Zotin me atë që ka dhe jo të thotë se çfarë do të bënte sikur të kishte më shumë para, kohë, ose njohuri. Nuk ka rëndësi se kush jemi apo se çfarë zotërojmë. Ajo që ka rëndësi është nëse ne jemi gati të dëgjojmë dhe të bëjmë atë që Zoti do prej nesh.

Nga: **ARJANA SPAHIJA**

Takimi kombëtar i motrave të Asambleve të Perëndisë më 9 shtator 2017 ishte një hap besimi. Për rreth 3 vjet, jemi lutur duke kërkuar drejtimin dhe bekimin e Perëndisë për të na e dhënë këtë mundësi që të mbledheshim së bashku nga çdo drejtim për një qëllim të vetëm: *Për t'i dhënë lavdi Perëndisë*. Ndoshta pasiguria nëse do të mund ta realizonim këtë takim u bë pjesë e jona. Por ajo që na dha forcë e siguri, ishte që u mbajtëm fort tek premtimi i Perëndisë. Besoj fuqishëm që ky takim ka qenë plani dhe vullneti i Zotit për jetën e çdo motre dhe për ndërtimin e çdo kishë në Shqipëri.

Në këtë takim morën pjesë afërsisht rreth 300 motra nga të gjitha kishat e Asambleve të Perëndisë në Shqipëri, 50 nga të cilat kërkuan lutje për përkushtim në Zotin, lutje për shërim, si dhe disa prej tyre bënë lutjen e shpëtimit për herë të parë. Koha e adhurimit, dëshmitë, drama, loja, Fjala e Zotit, lutja, kokteji, koha e miqësisë, ishin pjesë e bekimit në këtë takim. Ajo që na preku dhe na inkurajoi, ishte uniteti si edhe fryma e një bashkëpunimi të mirë ndërmjet kishave dhe drejtueseve të grupeve të motrave. Ishte e mrekullueshme të shikonim përkushtimin, zellin dhe dëshirën për të bërë më të mirën për këtë shërbesë.

Një motër tha: "Të mbledhurit së bashku në unitet na ndihmon që të arrijmë njerëzit e humbur dhe kombet."

Një motër tjetër u shpreh: "Takimi i motrave të kishave tona ka qenë takim i mrekullisë, sepse gjithçka që ka ndodhur, ka qenë unifikimi i asaj që do të thotë të jesh pjesë e trupit të Krishtit."





Kombëtar i Grave TË PERËNDISË

Gjithashtu një motër tjetër tha: *"Ishte shumë bekim takimi në të cilin të gjitha motrat nga kisha të ndryshme u mbledhën së bashku. Me të vërtetë, në këtë takim Perëndia ishte i gjallë dhe Ai preku zemrat tona. Është bukur të shikosh se si Perëndia vepron në jetën e çdo motre. I jam mirënjohëse Perëndisë për këtë takim të veçantë, sidomos për fjalën e ndarë në këtë ditë për thirrjen që na u bë secilës prej nesh që të rrimë zgjuar dhe të mbajmë shpresën e plotë në hirin që do të vijë mbi ne në zbulesën e Jezus Krishtit (1 e Pjetrit 1:13)."*

Dua ta mbyll duke ju inkurajuar me një varg tek Letra e Parë e Pjetrit 4:10, ku thuhet: *"Gjithsecili le ta vërë në shërbim të tjetrit dhuntinë që ka marrë."*

Perëndia na nxit të marrim përgjegjësinë tonë personale për çdo gjë që na besohet që të bëjmë. Njerëzit e përgjegjshëm janë gjithmonë të përkushtuar dhe nuk presin që të tjerët të bëjnë atë gjë të cilën duhet ta bëjnë ata vetë.

Mos harroni të kujtoni çdo ditë se Perëndia nuk thërret të aftët, por Ai aftëson të thirrurit. Motër, kushdo qofsh ti, mos harro se Perëndia të ka thirrur për një plan më të madh nga ai që ti ke në mendje. Në momentin kur ti e di në zemrën tënde se çfarë duhet të bësh, kërkoji Zotit fuqi dhe mbahu fort pas fuqisë së Tij. Kjo është marrja e përgjegjësisë personale.

Le të presim së bashku me gëzim takimin e radhës më 8 Shtator 2018 për një bekim akoma edhe më të madh! Zoti na bekoftë së bashku!



LAJMËRIME

për NGJARJE TË VEÇANTA

FUNDJAVA PASTORALE

Për të gjithë pastorët e Asambleve të Perëndisë dhe gratë e fëmijët e tyre.

23-25 mars 2018, në:

Pogradec

Rezervojini këto data në kalendarin tuaj tani, dhe ejani për t'u kënaqur me një kohë të veçantë pushimi, përtëritjeje e miqësie. Do të ketë përkujdesje për fëmijët e të gjitha moshave. Prisni për më shumë detaje dhe informacion për regjistrimin.

KTU organizon:

**Në kuadrin e
JAVËS SË THEKSIT MBI
MISIONIN**

Takim me: JOSH ROWAND

20-22 mars, 2018, ora 10:45-12:00

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet kombit të madh të Turqisë. Të gjithë janë të mirëpritur!

dhe:

**SEMINAR për SHËRBESEN ndër
MYSLIMANËT**

18-19 maj 2018

Folës: HANNU LAHTINEN, Koordinator
i Shërbesës ndër Myslimanët për Fida
International

Mësoni si të arrini efektivisht myslimanët
për Krishtin dhe si t'u përgjigjeni
pyetjeve të tyre kyçe.

**Seminari është falas.
Sponsorizuar nga Fida International**